



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 MAJ 2019 - VAZHDIM**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. MAJA 2019. GODINE - NASTAVAK**

**MAJ - MAJ
2019**

Rendi i ditës

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16 dhe 20 maj 2019

1. Votimi për formimin e Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë,
2. Vendimi për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit, tek ish - Fabrika e Tjegullave,
3. Vendimi për ndërtimin e Memorialit të Dëbimit Stacioni Hekurudhor i Prishtinës,
4. Caktimi i Ditës së Gjenocidit.

II. Shqyrtimi i Propozim-Amendamentit nr. 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i propozuar nga 80 deputetë të Kuvendit.

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7 mars 2019

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
3. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017,
4. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
5. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,
6. Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,
7. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,
8. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë,
9. Votimi për shkarkimin e një (1) anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare,
10. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës,
11. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë,
12. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave,
13. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,
14. Votimi në parim i Projektligjit për peticione,
15. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
16. Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
17. Votimi në parim i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
18. Votimi në parim i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve,
19. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës,

20. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,
23. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat,
24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës,
25. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit,
26. Votimi në parim i Projekt-Kodit të Procedurës Penale,
27. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
28. Votimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
29. Votimi në parim i Projektligjit për Diasporën,
30. Votimi në parim i Projektligjit të punës,
31. Votimi në parim i Projektligjit për pronën publike,
32. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike,
33. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247,
34. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me mosçaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës,
35. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP-Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a./NKEC.

IV. Pikat e papërfunduara nga Seanca plenare, e mbajtur më 30 janar 2019

1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,
2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore,
3. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
4. Votimi në parim i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

V. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, mbajtur më 28 shkurt 2019

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
3. Votimi në lexim të dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,

5. Votimi i rundit të dytë për zgjedhjen e gjashtë (6) anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
6. - Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
 - Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
 - Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radhët e komuniteteve joshumicë,
 - Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë.

Vl. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 12 mars 2019

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara.

VII. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 13 mars 2019

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti.

VIII. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 28 mars 2019

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për situatën e krijuar në arsim pas vendimit të SBASHK-ut për të refuzuar kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës 3-javore.

IX. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 11 prill 2019

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me zbrazjen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta.

X. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12 prill 2019

1. Shqyrtimi i Propozim-Programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike,
3. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributëdhënës,
4. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
5. Votimi i raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë të Republikës së Kosovës,
6. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-“KOSTT” sh. a.,
7. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për kompensimin e anëtarëve të këtij Komisioni,
8. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e zëvendëskryetarit të dytë në Komisionin ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social dhe Propozimi i GP të PSD për zëvendësimin e deputetëve në komisione parlamentare.

Dnevni red

I. Nedovršena tačke sa plenarne sednice održane 16 i 20 maja 2019. godine:

1. Glasanje za formiranje Državne komisije za osnivanje Tribunala o počinjenom srpskom genocidu na Kosovu,
2. Odluka o izgradnji Muzeja genocida, kod bivše Fabrike cigala,
3. Odluka o izgradnji Memorijala proterivanja, kod Železničke stanice u Prištini,
4. Utvrđivanje datuma genocida.

II. Razmatranje Predlog amandmana br. 26. Ustava Republike Kosovo, predložen od 80. Poslanika Skupštine.

III. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 7 mart 2019. god:

1. Drugo glasanje Nacrt zakona o porezu na lične dohotke,
2. Drugo glasanje Nacrt zakona o porezu na prihode korporacija,
3. Glasanje Godišnjeg izveštaja Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2017.godinu.,
4. Glasanje Izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja primene Zakona o bankama, mikro-finansijskim institucijama i nebankarskim finansijskim institucijama,
5. Glasanje Izveštaja Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije u vezi nadgledanja primene Zakona o zaštiti od diskriminacije,
6. Glasanje Izveštaja revizije godišnjih finansijskih pregleda Ministarstva kulture, omladine i sporta za 2017. godinu,
7. Glasanje Izveštaja o stanju životne sredine na Kosovu za 2017. godine,
8. Glasanje za Imenovanje 7 (sedam) članova u Kosovskom savetu za kulturno nasleđe,
9. Glasanje za Razrešenje jednog (1) člana Borda Regulatornog autoriteta elektronskih i poštanskih komuniciranja,
10. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi neuspeha i skandala spoljne politike Republike Kosovo,
11. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi angažovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije,
12. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa neuspesima vladajuće koalicije koji su kulminirali zbog ne liberalizacije viza,
13. Glasanje u načelu Nacrta zakona o javnom prenosniku Kosova,
14. Glasanje u načelu Nacrta zakona o peticijama,
15. Glasanje u načelu Nacrta zakona za zaštitu od buke,
16. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br.05/L-010 o Kosovskoj Agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
17. Glasanje u načelu Nacrta zakona o porezu na dodatu vrednost,
18. Glasanje u načelu N/zakona o lustraciji figura visokih službenika u Javnim Institucijama i izabranih,
19. Glasanje o preporukama od parlamentarne debate o slučaju seksualnog uznemiravanja i silovanja, nezakonitog abortusa maloletnice i institucionalnoj odgovornosti Vlade Kosova,
20. Drugo glasanje N/zakona o Specijalizovanom veću Vrhovnog suda u vezi pitanja Kosovke agencije za privatizaciju,
21. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 2004/22 o kinematografiji,

22. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 04/L-065 o autorskim pravima i srodnim pravima,
23. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 04/L-097 o bibliotekama,
24. Drugo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakonika o krivičnom postupku Republike Kosova,
25. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 05/L-042 o regulisanju usluga vode,
26. Glasanje u načelu N/ zakonika o krivičnom postupku,
27. Glasanje u načelu N/zakona o izmeni i dopuni Zakona o ličnoj karti,
28. Glasanje u načelu N/zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
29. Glasanje u načelu N/zakona o dijaspori,
30. Glasanje u načelu N/zakona o rada,
31. Glasanje u načelu N/zakona o javnoj svojini,
32. Prvo razmatranje N/zakona o jakim alkoholnim pićima,
33. Glasanje u načelu N/zakona o izmenama i dopunama zakona br.04/L-061 o prodaji stanova za koje postoji stanarsko pravo, izmenjen i dopunjen zakonom br.04/L-247,
34. Glasanje Predlog-rezolucije sa Interpelacije premijera Republike Kosovo, Ramush Haradinaj, na zahtev PG PSD, u vezi ne utvrđivanja i povećanja minimalne plate u Republici Kosovo,
35. Glasanje preporukama sa Interpelacija ministra za ekonomski razvoj g. Valdrin Lluca, na zahtev predsednika PG PSD g. Dardan Sejdiu, uz podršku 11 poslanika, u vezi osnivanja Novog energetskog preduzeća Kosova A.D./NKEC.

IV. Nedovršene tačke sa plenarne sednice održane 30. januara 2019. god:

1. Glasanje N/zakona o ratifikaciji za Dodatni Protokol 5 uz Sporazum o izmeni i pristupanju Centralno Evropskom Sporazumu o slobodnoj trgovini,
2. Glasanje u načelu Nacrta zakona za izmene i dopune zakona br.02/L-88 o kulturno nasleđe,
3. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
4. Glasanje u načelu N/zakona o visokom obrazovanju Republike Kosova.

V. Nedovršene tačke sa plenarne sednice održane 28. februara 2019. god:

1. Drugo glasanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.05/L-132 o vozilima,
2. Drugo glasanje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima,
3. Drugo glasanje Nacrta - poslovnika Skupštine Republike Kosova,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
5. Glasanje u drugoj rundi za izbor šest (6) članova Saveta za besplatnu pravnu pomoć,
6. - Formiranje komisije ad hoc za izbor kandidata za dva (2) članova Odbora Radio-televizije Kosova,
 - Formiranje komisije ad hoc za izbor kandidata za tri (3) članova Odbora Radio-televizije Kosova,
 - Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za dva (2) člana Nezavisne komisije za nadzor civilne službe Kosova, iz redova ne većinskih zajednica,
 - Formiranje ad hoc komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije, iz redova drugih ne većinskih zajednica.

VI. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 12. marta 2019. godine:

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata o odluci Vlade Republike Kosovo za izdvajanje finansijskih sredstava iz nepredviđenih troškova.

VII. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 13. marta 2019. godine:

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa blokiranjem Centralne izborne komisije od strane Predsednika.

VIII. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 28. marta 2019. godine:

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata o nastaloj situaciji u obrazovanju, nakon odluke USONK-a za odbijanje naknade izgubljenih časova, tokom 3 nedelje.

IX. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 11. aprila 2019. godine:

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi napuštanja zemlje od omladine, kao najveći rizik koji pretil zemlji od posleratnog perioda.

X. Nedovršena tačke sa plenarne sednice održane 12. aprila 2019. godine:

1. Razmatranje Predlog - programa rada Skupštine Republike Kosovo za 2019. godinu,
2. Drugo razmatranje N/zakona br. 06/L-081 o pristupu javnim dokumentima,
3. Glasanje Predlog - rezolucije od parlamentarne debata, na zahtev poslanice Teuta Haxhiu, podržan od 9. (devet) poslanika - potpisnika za održavanje parlamentarne rasprave o pravima penzionera platiša doprinosa,
4. Glasanje Predlog - rezolucije od parlamentarne debata, na zahtev poslanika Faton Topalli o neizvršenju Presude Ustavnog suda Republike Kosovo,
5. Glasanje Izveštaj Parlamentarne istražne komisije u vezi sa troškovima za lobiranje od strane Predsednika i Vlade Republike Kosova,
6. Izbor članova borda Javnog preduzeća operator sistema, transmisije i tržišta -"KOSTT" sh. a.,
7. Zahtev Parlamentarne Anketne Komisije vezano za troškove lobiranja od strane Predsedništva i Vlade Republike Kosova, za nadoknadu članova ove Komisije,
8. Predlog PG SL za imenovanje drugog zamenika predsednika ad hoc komisije za izradu Zakonika o regulisanju i menadžiranju penzija i beneficija socijalnog osiguranja i predlog PG PSD za zamenu poslanika u parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës si në vijim.

Jemi te pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16 dhe 20 maj 2019.

1. Votimi për formimin e Komisionit Shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 16 dhe 20 maj 2019, ndërsa sot procedojmë vetëm me votim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Faleminderit!

Do të votojmë edhe një herë, për arsye se po kthehen disa nga deputetët, i vendosin edhe kartelat.

Janë katër deputetë që kanë kërkuar fjalën, a qëndron në bazë të Rregullores. Jemi në vazhdim të seancës, a qëndron në bazë të Rregullores, ekspertët tuaj, ma thoni dhe merrni fjalën. Në qoftë se është për manipulim, urdhëro, merrni, a qëndron në bazë të Rregullores së Kuvendit? Jemi në vazhdim.

Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Të nderuar familjarë të viktimave të luftës që jeni këtu të pranishëm dhe ju që nuk jeni të pranishëm,

Jemi tubuar sot për një çështje shumë të rëndësishme, e cila është adresuar këtu në Kuvendin e Kosovës, më lejoni që në fillim të them që Partia Social Demokrate e kupton këtë çështje si shumë të rëndësishme dhe është për krijimin e Tribunalit dhe vënien e drejtësisë, është për atë që të gjithë ata që kanë shkaktuar krimet e luftës të ndiqen dhe ne jemi të gatshëm të japim kontributin tonë në këtë drejtim.

Meqë kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe i kalon ato vijat partiake, interesat partiake, të cilat edhe mund të shpërfaqen, jemi të mendimit që duhet të krijohet një konsensus mbipartiak, pra të gjitha partitë apo shumica e partive politike këtu në Kosovë t'i ndërtojmë ato mekanizma, të merremi vesh për të gjitha çështjet me njëri-tjetrin, duke pasur parasysh seriozitetin e kësaj çështjeje që bashkërisht pastaj të vendosim për hapa të cilët duhet t'i ndërmarrim.

Pra, jemi për atë që të punojmë në drejtim të krijimit të Tribunalit, por jemi edhe atë që ta trajtojmë seriozisht këtë çështje dhe të mos e lëmë si nismë individuale të një partie, po të gjejmë një konsensus të përbashkët pozitiv - opozitiv që kjo çështje pastaj të adresohet pa nguti, në mënyrë që t'i arrijmë edhe qëllimet për të cilat sot po diskutojmë.

Në shërbim të kësaj unë propozoj, në emër të Partisë Social Demokrate, para Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh që nuk ka unifikim mes partive politike që ta krijojmë një Komision parlamentar, i cili do ta marrë këtë bazë, të cilën e kemi nga propozuesi, t'i harmonizojmë qëndrimet dhe, posa të bëhet harmonizimi i qëndrimeve, të shtrohet kjo çështje për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Topalli! Qëndrim shumë dinjitoz, për faktin se të paktën është mirë në këtë formë të thuhet kur ka iniciativë. Unë edhe në seancën e kaluar e thashë, në qoftë se ka të bëjë me çështje individuale, jo se jam në gjendje të heq dorë prej vetvetes, po kurrë emri im mos u përmend! Por, kanë kaluar dy dekada dhe askush, as në këtë Kuvend, as askund, nuk ka marrë iniciativë. Bile goxha më bën nder, po kjo iniciativë do të shkojë deri në fund, s'mund të ndalet. Nuk ka nevojë fare të improvizohet, dalin nga grupet parlamentare në qoftë se dëshirojnë nga një, e improvizojnë si donë, në mënyrën që të largohet iniciativa nga emri im, e sjellim dhe e votojmë sot, se kemi edhe shumë gjëra të tjera për të votuar.

Do të thotë, e rëndësishme është që të orientohet edhe të votohet me përgjegjësi të plotë nga ky Kuvend Tribunali, përkatësisht Komisioni Shtetëror si fazë e inicimit për Tribunal ndërkombëtar për gjenocidin serb në Kosovë. Kjo është me rëndësi, se kush e bën, se si propozohet, si modelohet, sot duhet të votohet, ose në fund të fundit, prej jush jepet përgjigje para përgjigje para qytetarëve, për faktin se tash po e shoh, ndërkohë kemi edhe një propozim të kësaj natyre për afërsisht, rezolutë tash, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Vetëm diçka, ju jeni brenda seancës së Kuvendit, jemi në vazhdim të seancës së Kuvendit në bazë të Rregullores së Kuvendit...

(Reagime nga salla)

A ka mundësi një qartësim për hir të publikut.

Proceduralisht rezolutat si grup parlamentar i dini fare mirë se si shkojnë, s'mund të më tregosh hiç, se është Rregullorja e Kuvendit, unë nuk e përfaqësoj veten, po e përfaqësoj Kuvendin. Jam interpretues i Rregullores së Kuvendit.

Do të thotë, edhe kjo është njëjtë, e cila në bazë të procedurave nuk keni të drejtë ta sillni sot për hir të... devijoni nga iniciativa, e cila është për votim.

Sot është data 30 maj. Kjo u dorëzua sot, Armend, nuk u dorëzua nga java e kaluar.

A dëshironi seanca të vendosë të vazhdojmë seancën, në rend të parë Faton Topalli e ka një propozim.

(Reagime nga salla)

Unë e përcaktoj a keni të drejtë a jo, pasi Rregulloren po doni ta respektoni, unë do ta respektoj Rregulloren e Kuvendit.

Është një propozim i Faton Topallit, pastaj do të shkojmë në propozimin po ashtu të Lidhjes Demokratike të Kosovës, rend dhe të çdo grupi parlamentar që ka propozim.

Është një propozim i Fton Topallit, ka bërë një propozim konkret. A dëshironi, po nuk mund ta tejkaloji një propozim për të imponuar vullnetin tuaj, se s'jeni ju këtu që impononi.

Faton Topalli pati një propozim, a dëshironi ta vëni në votim propozimin e Faton topallit apo jo? Seanca e vendos, po, jo, votoni. Përgatituni për votim, propozim konkret. Zoti Topalli, a dëshiron edhe një herë ta sqarosh propozimin tuaj?

Ju lutem, thirrni deputetët, pastaj kalojmë edhe te kjo pjesa e propozimit të LDK-së, qartëso, pastaj deputetët le ta votojnë, do të bëj përjashtim, për faktin se tek e fundit, kjo seancë e Kuvendit, deputetët e vendosin se si do të rrjedhë seanca. Të lutem.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë po e përsëris edhe një herë atë që thashë më herët. Mendojmë si parti Social Demokrate që kjo i tejkalon suazat e një partie.

Prandaj, jemi shumë të interesuar për një çështje kaq të rëndësishme të kemi konsensus, edhe Lidhja Demokratike mendoj që shkon në shërbim të rezolutës, sepse ka mundësi që kjo çështje pastaj brenda këtij komisioni të diskutohet dhe të adresohet.

Propozimi im konkret është që Kuvendi i Kosovës të krijojë një komision parlamentar, i cili pastaj do ta ketë për bazë tekstin e dorëzuar, t'i harmonizojmë qëndrimet dhe pastaj bashkërisht, pra duke pasur parasysh këtë rëndësi të madhe të çështjes, për të cilën ne kemi diskutuar edhe javët e kaluara në Kuvend, që të ulemi bashkërisht dhe ta harmonizojmë një tekst, i cili do të miratohet me shumicën e anëtarëve të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet! Është propozim konkret, shkojmë në votim në mënyrë elektronike. Do të vazhdojmë edhe këtë pjesën.

Votojmë tash, po, jo, votojmë tash. Votoni, deputetë, për propozimin e Faton Topallit.

61 deputetë kanë votuar, edhe një me dorë, kush është, Milaim Zeka, 62 për, aprovohet propozimi i zotit Topalli.

Shkojmë te Lidhja Demokratike e Kosovës, urdhëroni zoti Hoti!

Ju lutem, krejt çfarë po bëjmë është transparente. Vetëm pak, për korrektësi, asnjë veprim deri jemi futur në seancë të Kuvendit s'kemi pasur njoftim as për iniciativën e zotit Topalli, as të Lidhjes Demokratike.

AVDULLAH HOTI: Jo, të lutem, të lutem!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Unë po mendoj që e keni filluar menjëherë me lojë seancën e kësaj dite. Rezoluta, të cilën sot e kemi protokolluar, është lexuar dhe kjo mund të dokumentohet në transkriptin e seancës së kaluar, është lexuar në emër të Grupit Parlamentar dhe unë sot e kam edhe e kam protokolluar dhe kam kërkuar dhe kërkoj prapë që kjo rezolutë të hedhet në votim. Nuk jemi duke propozuar tjetër gjë sot dhe jashtë procedurave, po është rezolutë e lexuar në foltoren e Kuvendit dhe rezoluta thotë kështu:

Pika e parë, formohet grupi punues me anëtarë nga të gjitha grupet parlamentare për të përgatitur propozim-vendimin që duhet të marrë Kuvendi lidhur me veprimet që duhet të ndërmerren nga institucionet kompetente të Kosovës për ndjekjen dhe dënimin e kryerësve të krimeve të luftës, fillimisht nga drejtësia vendore dhe mandej edhe nga drejtësia ndërkombëtare.

Pika e dytë, propozim-vendimi duhet të përmbajë ndryshime legjislative që janë të nevojshme për të krijuar infrastrukturën ligjore si dhe kapacitetet institucionale për të ndjekur dhe dënuar kryerësit e krimeve të luftës edhe në mungesë.

Pika e tretë, këto ndryshime legjislative duhet të përmbajnë detyrime të institucioneve të drejtësisë të Kosovës për mbledhjen e provave që lidhen me krimet e luftës.

Pika e katërt, pas kryerjes së këtyre veprimeve nga institucionet e drejtësisë, shteti i Kosovës duhet të angazhohet në rrafshin diplomatik për të kërkuar nga partnerët tanë strategjikë krijimin e Tribunalit ndërkombëtar për krimet e luftës në Kosovë.

Kjo është rezoluta që është propozuar në seancën e kaluar dhe unë kërkoj që ju këtë ta hidhni në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po më vjen keq.

Për opinionin publik dhe për deputetë, krejt ajo çfarë jemi duke u munduar është të bëjmë një interpretim të Rregullores, në bazë të standardeve, të cilat i ka krijuar ky Kuvend dhe nuk është interpretim i kryetarit të Kuvendit, edhe ky konsultim, kjo ishte arsyeja me deputetin. Të gjitha do të ishte në rregull, vetëm të ishte dorëzuar me shkrim.

(Reagime nga salla)

Ju e dini se si dorëzohet. Jo, jo, pritni pak. Nuk ka nevojë të jeni kaq emocional dhe kaq të përgatitur për devijuar ose manipuluar. Unë do të vë çdo propozim, sa të jem kryetar i Kuvendit, po nuk është e sinqertë të tentohet fajin tuaj t'ia vëni tjetërkujt.

Zoti Krasniqi, fjala për ju!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Prapë sot jemi, si të thuhet, në të njëjtën situatë sikur në seancat e kaluara, kur një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme për të gjithë shqiptarët e Kosovës ne jemi duke e rrezikuar për shkak të tendencës për protagonizëm të kujt do qoftë. Përkundër faktit që debati ka përfunduar për këtë pikë dhe tashmë sipas procedurave dhe Rregullores së Punës së Kuvendit, ne duhet vetëm të votojmë pro ose kundër, ashtu siç edhe vendosët në votim. U dha një propozim nga Partia Social Demokrate, e cila e mori mbështetjen e shumicës së deputetëve dhe tashmë kaloi.

Ne e kemi një propozim tash të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pa dashur t'i vlerësoj procedurat, tek e fundit është një temë aq e rëndësishme, ndonjëherë mund të kemi dakordim edhe për tejkalim të tyre, kur janë në interes të qytetarëve, por këta çka propozuan, për mendimin tim, përkundër që kurrkush prej deputetëve s'e ka të shkruar, vetëm e dëgjua qysh u lexua, është e njëjtë me atë çka e kaluam ne. Besoj që Kuvendi sapo e miratoi propozimin që të krijohet një komision parlamentar i përbërë prej të gjitha grupeve parlamentare për t'i përgatitur këta hapa, të cilët tash i lexuan në rezolutë. Do të thotë, ku është logjika tash të bëjmë edhe një komision? A jemi duke folur për komisionin që e propozoi PSD-ja veç, tash LDK-ja, pak në formë ndryshe? Apo jemi duke folur për dy komisione? Sepse, ne e kaluam, ky Kuvend e votoi një Komision parlamentar për këtë punë. Çka po lypni tash? Edhe një komision tjetër apo mos po doni atë komision që e kaluam t'ia japim këtë mandat?

Ju lutem, seriozisht ju lutem, harrojeni veç për një moment protagonizmin prej neve të PDK-së, e juve të LDK-së, e të gjithë të tjerët bashkë. Të merremi vesh për këtë temë, sepse me të vërtetë u bëmë horë para këtyre njerëzve që i përfaqësojnë familjet e të zhdukurve që i kemi në sallë, e edhe më shumë prej atyre që janë duke na përcjellë. Nëse ka vullnet të kalohet kjo punë, ashtu

siç kemi vullnet ne, po merremi vesh, u themelua një komision, ejani në komision të merremi vesh për çdo hap tjetër. Keni pasur kritika, ta zëmë, ju besoni në to, s'po jua kontestoj dhe ne jemi të gatshëm, ashtu siç u kalua ky propozim, që një komision parlamentar, i përbërë prej krejt grupeve parlamentare, takohet dhe të diskutojë për të gjithë hapat, po për shkak të protagonizmit me thënë e bëmë ne, s'e bëtë ju, e bëri ky, e bëri ai, të mos e rrezikojmë këtë proces.

Mezi kemi ardhur në pikë kur po flasim, kemi konkretisht propozime për këtë punë. Kaloi komisioni, ju lutem, të merremi vesh, kush janë anëtarët e këtij komisioni që e votuam dhe po shkojmë sot, qysh sot po takohemi dhe po diskutojmë bashkë, edhe me ato pika që i propozuat ju. Sinqerisht, po jua ripërsëris, nëse doni besoni, nëse doni, mos besoni, sepse mosbesimi na ka sjellë në këtë ditë. Nuk e kemi protagonizmin me rëndësi, e kemi me rëndësi të përgatiten vërtet hapat konkretë, të cilët mundësojnë themelimin e një Tribunali ndërkombëtar për gjenocidin serb. Nuk është me rëndësi cili propozim shkon, e miratua një propozim, andaj po ju lus, si koleg, si deputet i Kuvendit të Kosovës, para se të jem partiak, po merremi vesh, po takohemi, meqenëse e kaluam një komision, tek e fundit, po shkojmë si shefa të grupeve parlamentare, po diskutojmë dhe po vijmë prapë në seancë, qoftë sot, qoftë nesër, qoftë javën e ardhshme, kur të doni, kur të merremi vesh bashkë, po më së miri është sot, dhe po vijmë po e propozojmë qoftë një rezolutë të përbashkët, qoftë çka të doni. Nuk është me rëndësi të thuhet “kaloi rezoluta e PDK-së ose e LDK-së”. Le të kalojë rezoluta e Kuvendit të Kosovës, këtë herë, së paku. Kemi me çka të bëjmë politikë, me 100 tema të tjera, siç po bëjmë për ditë, mbarë e mbrapshtë.

Por, sot e kaluam një Komision parlamentar, tash menjëherë ose pas 10 minutave, ose në 12:00, kur të thoni ju, po takohemi shefat e grupeve, si u miratua komisioni dhe po diskutojmë për të gjithë hapat në mirëkuptim, në mirëbesim çka të bëjmë dhe sot po e votojmë, duke u bazuar në atë dokumentacion që e kemi, në këtë rezolutë tekst, draft që po e propozoni ju dhe të dalim me diçka të përbashkët, e cila na bën nder të gjithëve, se ky debat nuk është duke na bërë nder kurrkujt, as individualisht, as si parti politike, as si Kuvend i Kosovës. Ju lus, kolegë, ta tejkalojmë vetveten këtë herë. Ta tejkalojmë vetveten edhe protagonizmin partiak e politik, po merremi vesh bashkë, e kaluam komisionin, po takohemi. Faleminderit!

KRYETARI: Avdullah, unë fjalën ta dhashë më herët, do ta jap prapë, por nuk do të lejoj të hapet diskutim për këtë çështje, foli Partia Socialdemokrate, Partia Demokratike, ju si Lidhje Demokratike, borxhi i kam Bilallit, e ka kërkuar fjalën dhe njëri nga Lëvizja Vetëvendosje, gjithsesi, e pastaj futemi drejtpërdrejt në seancë. Urdhëro, pasi Memli është i të njëjtit grup parlamentar, ku është edhe kryetari, po urdhëro, po për besë po bëjmë diçka çka nuk është dinjitoze dhe po abuzohet shumë me këtë Kuvend. Regjia, të lutem, zotit Hotit fjalën!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Kjo që tash e tha deputeti Krasniqi, unë besoj që nuk ia vlen të hyjmë më thellë në këtë çështje, nëse duam të shkojmë përpara, atëherë të dakordohemi, të shkojmë përpara. Ne nuk jemi duke tentuar të marrim flamurin në këtë çështje, por rezoluta që

është propozuar në seancën e kaluar nga ju, kryetar i Kuvendit, bie ndesh me të gjitha normat e ndarjes së pushtetit dhe plot çështje të tjera, e kemi diskutuar gjerësisht brenda grupit tonë parlamentar.

Unë besoj këtë që e tha përfaqësuesi i PSD-së, për Komision parlamentar ad hoc mund të kombinohet plotësisht dhe përmes rezolutës tonë t'ia përcaktojmë mandatin këtij Komisioni parlamentar ad hoc. Unë kërkoj që kjo rezolutë të hidhet në votim dhe besoj që e përbën bazën për punën e këtij Komisioni parlamentar që u propozua dhe lehtësisht për dy javë ne mund të vijmë para këtij Kuvendi për veprimet konkrete që duhet të ndërmerren nga institucionet e Kosovës.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Kryetari Veseli e ka fjalën!

KADRI VESELI: Faleminderit!

U nxita jo veç nga ky deklaram juaji, por edhe nga seanca e kaluar.

I nderuar kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
Në rend të parë, krejt çfarë bëjmë këtu, e bëjmë për hir të një interesi qytetar. Në qoftë iniciativa, ndonjëherë, të cilat mund edhe të mos na takojnë ne. Për dy dekada askush asnjë iniciativë nuk e ka ndërmarrë, as në këtë Kuvend, as në institucione të tjera për çështjen e gjenocidit serb. Çdo vit kemi vajtuar, kemi folur, por hapa konkretë nuk janë ndërmarrë. Pse u desh pikërisht kur u hap një iniciativë të ketë gjithë këtë fushatë të rëndë? Pse u desh gjithë këto insinuata, intriga në këtë proces, në këtë Kuvend është folur, janë marrë iniciativa, janë ndërmarrë hapa, të cilët kurrë s'i kanë takuar këtij Kuvendi, e nuk është bërë kaq shumë zë. Kjo iniciativë nuk ka të bëjë as me mua, as me ty, ka të bëjë ndoshta më shumë me fëmijët e tu edhe të mitë të mos u ndodhë nesër ajo çka na ka ndodhur para 20 vjetëve mua e ty.

Ju merreni si të doni, unë nuk e kam ndërmend të marr flamur në këtë punë. Le ta marrë kush të dojë, por ajo duhet të ndodhë dhe të shkojë deri në fund, si iniciativë. Edhe këtë rezolutë tani unë do ta vë në votim, e vendos Kuvendi i Republikës së Kosovës, merreni rrotullojeni si të doni, vërjani çfarëdo emri, zhdukeni çdo emër që ka qenë deri tash, po iniciativa duhet të shkojë deri në fund. Kjo është, edhe institucioni duhet të marrë përgjegjësi, jo të manipulojë askush me qytetarët, as me ndjenjat tona.

KRYESUESI: Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Unë vetëm e kërkoj nga Bilalli, po edhe Lëvizja Vetëvendosje, dy grupet parlamentare që duhet të flasin, edhe ju, Ahmet. A dëshironi të flisni para se ta vë në votim propozimin e rezolutës? Para, a? Para! Atëherë, pastaj të kemi mirëkuptimin, përfundohet, nuk do të lejojmë të vazhdohet me debate të stërzgjatura, futemi në rend të ditës. Bilall Sherifi ka qenë i pari që e ka kërkuar fjalën, në fakt, Albin, paske qenë më herët, kërkoj falje. Bilall, a ka mundësi t'ia jap fjalën Albinit se para jush qenka në radhitje?

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Familjarë të të pagjeturve, të dëshmorëve, të martirëve të kombit,
Deputetë të Kuvendit,
Kabinet i Qeverisë,

Në këtë situatë ndodhemi si pasojë e idesë së kryetarit të Kuvendit dhe shefit të PAN-it për një Tribunal ndërkombëtar për gjenocidin e Serbisë. Pra, e kemi kontekstin, e kemi edhe pretekstin, por nuk e kemi tekstin, se si ndërtohet, çka bën, si ec e ku mbërrin ky Tribunal ndërkombëtar nuk dihet prej askujt tash e sa kohë, ndonëse po kalojnë ditët e kësaj ideje si propozim. Edhe nëse do të ishte e mundur që të realizohet një Tribunal i tillë ndërkombëtar, kushedi edhe sa vjet i merr themelimi e funksionimi i tij. Gjykata Speciale më 3 gusht i bën 4 vjet prej se është mundësuar me amandamentimin 24 të Kushtetutës tonë. Gati 4 vjet më vonë nuk ka as aktakuza, e lëre më gjykime e dënime. Pra, kur thuhet “Tribunal Ndërkombëtar”, kjo merr tepër shumë kohë, merr tepër shumë energji. Dhe, të flasësh për Tribunal ndërkombëtar, nuk do të thotë të ngutesh, do të thotë, përkundrazi, të mos ngutesh. Ideja për Tribunal ndërkombëtar i jep kohë Serbisë, i jep kohë kundërshtarit tonë.

Pra, në kundërshtim me atë që proklamohet nga kreu dhe zëdhënësit e tjerë të PAN-it, ideja e nxituar për Tribunal ndërkombëtar, në fakt, i jep më shumë kohë Serbisë, sepse do të kalojnë shumë vjet deri sa të themelohet e të fillojë funksionimi i një Tribunali të tillë. Me këtë ide, Serbia sigurohet se edhe për një dekadë nuk do ta gjejë gjë.

Tribunali ndërkombëtar, prej kur lind ideja deri kur të themelohet e të funksionojë, shumë vjet shkojnë. Katër shkuan për Gjykatën Speciale, a kjo është shumë më e madhe se Gjykata Speciale. Dhe, mos harroni, Gjykata Speciale e ka Holandën si vend, me të cilin ka raport dhe quhet Tribunal ndërkombëtar, në fakt, është vendore, por e ka edhe karakterin ndërkombëtar. Cili është vendi ndërkombëtar tjetër i Republikës së Kosovës, siç e ka Gjykata Speciale Holandën? Ne nuk e kemi asnjë vend tjetër. Si mund ta quajmë Tribunal ndërkombëtar kur nuk e kemi edhe një shtet tjetër përveç Republikës së Kosovës? Kjo është absurde.

Shteti i Kosovës nuk ka kohë për të humbur për vete dhe as kohë për t'i dhënë Serbisë. Kriminelët janë të lirë, dëshmitarët janë të gjallë, duhet të ecim shpejt, por ideja për Tribunalin ndërkombëtar është ide që të ecim ngadalë, jo që të ecim shpejt. Nëse duam të ecim shpejt, nuk

ecet me Tribunal ndërkombëtar. Tribunali ndërkombëtar merr vite, mijëra faqe do t'i marrë para se t'ia nisë punës dhe po vdesin dëshmitarët, edhe ne po dobësohemi në ndjekjen e krimit serb.

Dihet që Serbia e Kroacia kanë të drejtë të gjykojnë në mungesë, kurse Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina jo. Pra, pikërisht shoqëritë e viktimave nuk e kanë ende këtë të drejtë! Kosova është në prag të ndryshimit të kësaj përmes plotësimit e ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale që ndodhet për votim në lexim të dytë dhe vetë kryetari i Kuvendit e ka vonuar këtë gjë.

Prandaj, propozimi është ky, konkretisht: le ta mundësojmë gjykimin në mungesë dhe le të punojnë prokurorët tanë. Kemi mjaftueshëm deputetë sot, ja po e vëmë menjëherë në rend të ditës dhe po e votojmë në lexim të dytë mundësinë për gjykim 'in absentia', për gjykim në mungesë. Nëse duam të ngutemi, kjo është rruga. Nëse duam të vonohemi, rruga është Tribunali ndërkombëtar.

Nuk mund të ngutemi me idenë e Tribunalit ndërkombëtar. A e di si i bie kjo? Hajde të ngutemi, sepse duhet ta ndërtojmë metron! Një ngrehinë gjigante, për diçka tepër të madhe, dëshiron të ngutesh. Të gjithë e dini atë fjalinë e famshme të Benjamin Franklinit: "dështimi në përgatitje është përgatitje për dështim". Kjo ide, kështu shpejt e shpejt, me votime, me 61 vota, a u bënë a s'po bëhen, kjo është përgatitje për dështim, sepse është dështim në përgatitje. Me tribunale ndërkombëtare nuk ngutesh, por vonohesh! Jemi vonë, por nuk jemi tepër vonë. Me tribunal ndërkombëtar bëhemi tepër vonë.

Më shumë formë, nuk do të thotë më shumë funksion. Më shumë qenie, nuk do të thotë më shumë bërje. Më shumë entitete, nuk do të thotë më shumë punë. Madje, në këtë rast, është edhe më keq se kaq: po duan të shpikin forma të reja që qytetarët të ndalen dhe të shpresojnë, të fitojnë këta kohë për vete, të pritët për funksionimin e vjetër të një forme më të re që premtohet, në vend se të kemi menjëherë funksionim të formës ekzistuese të vjetër. Ne i kemi prokurorët tanë, 192 prokurorë i kemi. Ata paguhen me taksat tona. Le ta votojmë mundësinë për të dënuar në mungesë. A duam të ngutemi? Kjo është rruga! Tribunali Ndërkombëtar i jep kohë Serbisë, jo neve. Neve na merr kohë, sepse të shkretit familjarë të viktimave do të thonë, e po tash po e presim këtë tribunalin ndërkombëtar... edhe shkojnë vite. A po ngutemi? Ejani në votim në lexim të dytë, menjëherë le ta bëjmë plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale. Kjo quhet ngutje. Tribunali Ndërkombëtar është vonim.

Disa prej këtyre 192 prokurorëve janë edhe për ndjekjen e krimeve të luftës. Le ta rrisim numrin e tyre. Tre, tash për tash, i ndjekin krimet e luftës, le t'i bëjmë 30. Por le t'ua krijojmë mundësinë, si Kroacia, që t'i akuzojnë, gjykojnë e dënojnë në mungesë kriminelët e luftës. Pra, le t'i pajisim ata me mundësinë për të gjykuar në mungesë.

Të nderuar deputetë,

Për bindjen time të fuqishme, dëshirat fëmijërore janë më pak naive e janë më shumë serioze sesa kjo ideja për Tribunalin Ndërkombëtar për dënimin e gjenocidit të Serbisë. Përfundimisht, edhe njëherë po e theksoj, nëse jemi të singertë në iniciativë e nëse e kemi seriozisht realizimin e saj, le të përgatitemi për ta paditur Serbinë për gjenocid në GjND, siç kanë propozuar ekspertët, profesionistët më të mirë që i kemi, Furtuna Sheremeti dhe Robert Muharremi. Kjo është e para: le ta padisim Serbinë në GjND për gjenocid. Dhe, e dyta, sot, këtu, menjëherë, në votim në lexim të dytë, plotësim-ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale, i cili i jep mundësinë prokurorëve tanë për gjykim në mungesë të kriminelëve serbë të luftës. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Të nderuar qytetarë të Republikës!

Të nderuar familjarë të viktimave të luftës,

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë,

Deputetë,

Unë sot nuk besova se do të rihapet debati për pikën e rendit të ditës të cilën e kemi përfunduar. Pra, kemi debatuar tërë ditën dhe jemi në momentin kur duhet të votohet. Po në rregull. Nga debati nuk humbet asgjë, veç çka mund të fitojmë. Ejani pra po e rihapim debatin.

Po filloj me propozimin që e dha deputeti Faton Topalli. Fatoni tha kështu: kryetari i Kuvendit e ka ofruar një dhomë të mbushur me orendi dhe nuk po na pëlqen dy palëve, tri palëve, nuk po na pëlqen qysh e ka mbushur me orendi. Pra, hajde ta bëjmë një dhomë të zbrazët, në mënyrë që dëshira e të gjithëve pastaj. O Rexhë! Ish-kolegu yt, për të cilin keni qenë në gjende të jepni jetë. Së paku kështu keni deklaruar, por lëre atë.

Tash doli propozimi i Avdullah Hotit, tha tash unë e kam një propozim qysh duhet ta mbushim atë dhomë. Nuk po na pëlqen ajo mënyra qysh e ka dizajnuar kryetari i Kuvendit, ja ne jua japim idenë se qysh ta mbushni, çfarë orendish të futen. Edhe doli tash kolegu tjetër, në fund jo, jo tha diçka prej asaj, diçka prej kësaj. Po kjo është lojë. E kjo është tash çka po bëhet lojë.

Unë mendoj që për të dalë nga kjo situatë, po është i pranueshëm, prandaj edhe e votova propozimi i deputetit Faton Topallit. Të krijojmë një komision ku së bashku të shohim se qysh po e mbushim me orendi atë. Dakord jam. E bëjmë edhe këtë. Nuk jam i gatshëm që të votojë kundër Avdullah, propozimeve të juaja, prandaj isha kundër që të hedhet në votë. Se nuk jam i gatshëm të votojë kundër disa propozimeve tuaja, ka propozime jashtëzakonisht me vend. Prandaj nuk dua të votoj kundër, por nuk mund të votoj as për, për disa nga arsyet të cila i potencova.

Hajde, ejani ta bëjmë një komision ku të ulemi pra së bashku një ditë, dy, një javë, dy, dhe të shohim se çfarë dhome duam, si duam ta mbushim me orendi, si duam ta dizajnojmë krejt atë dhomë. Në rregull jemi.

Tash, po dal tash unë pak, se u hap debati, te Tribunali. Kushdo që besoj që tribunali duhet të jetë zëvendësim për punën e gjyqësisë së Kosovës, ai ose është naiv, ose është dashakeq. Kushdo që e beson. Po kushdo që mendon, apo beson, apo e thotë, edhe pse nuk e beson, se këto të dyja përjashtojnë njëra-tjetrën, ose është naiv, ose është dashakeq. Për mendimin tim, për bindjen time. Jam i bindur që këto të dyja nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Ligji që e kam thënë edhe në fjalën time që e kam pasur në emër të Nismës kur ka qenë kjo çështje në rend të ditës, Ligji për dënim në mungesë gjithsesi duhet të vijë. Proceset gjyqësore gjithsesi duhet të mbahen nga gjykatat e vendit. Duhet akuza të ngrihet nga Prokuroria e Kosovës, gjithsesi.

Tribunali le të mbetet siç, nga presioni, përshtypja ime është publike, e ka përkufizuar jashtëzakonisht bukur kolegu Albin Kurti, një objekt i largët. Le të mbetet aty. Kujt i pengon? Le të mbetet ta mbajmë në tavolinë dhe t'ua themi sa herë që takohemi me kolegët ndërkombëtarë se ashtu siç keni bërë presion në Kosovën, në deputetët e Kosovës, në Parlamentin e Kosovës, në politikanët e Kosovës që të kalojë një version miks ndërkombëtaro-vendor, ligjet vendore, përbërja ndërkombëtare, duam gjithsesi një model që krimet e Serbisë të gjykohen, që i ka kryer në Kosovë. Pra, le të mbetet, po jo të presim, dakord jam. Jo të presim derisa ai tribunal të bëhet, ne duhet t'i kryejmë punët tona. Nëse s'mjaftojnë këta prokurorë dhe numri i gjykatësve, le t'i shtojnë. Le të ndahet një buxhet dyfish nëse ka nevojë i sistemit të drejtësisë, enkas për këtë çështje. Kështu mund të dëshmojmë se të gjithë duke u angazhuar në këtë çështje, e kemi seriozisht. Se askush nuk e ka për protagonizëm dhe pastaj askush nuk është duke e bërë këtë për kundërprotagonizëm. Pra, le të zhvishemi nga protagonizmi dhe kontraprotagonizmi dhe le t'i qasemi punës, le të punojmë te ajo dhoma e zbrazët ku secili, ku do të fusim aty nga shija e secili, po e marr kështu si metaforë.

Dhe për fund, Kryetar, përsëritës gatishtërinë që të hiqet dorë nga protagonizmi. Prandaj, ju lus të gjithë juve që të hiqni dorë po ashtu nga kundërprotagonizmi dhe të ulemi disa propozime shumë të mira që ishin nga Lidhja Demokratike, disa që i kanë thënë edhe në foltore, dhe disa nga VV-ja, po ashtu edhe nga PDK-ja dhe ta bëjmë bashkë. Le të dalë si iniciativë e përbashkët. Komisioni i propozuar për mendimin tim dhe në emër të Nismës nga kolegu Faton Topalli ofron një zgjidhje, ofron një mundësi për të lëvizur përpara. Përndryshe do të vazhdojmë këtu të qëndrojmë dhe të akuzojmë njëri-tjetrin, se ti e ke për protagonizëm, unë për patriotizëm, pastaj jo s'e kam për protagonizëm, por për patriotizëm. Ti e ke për të bllokuar vendin, e kështu me radhë. Unë nuk besoj që asnjë parti politike këtu në Kosovë shqiptare këtu dhe të komuniteteve joshumicë, me përjashtim të Listës serbe është kundër Kosovës.

Unë nuk besoj që një deputet, cilido qoftë ai nuk është i gatshëm të kontribuojë që të ofrohen mekanizma të duhur për t'i gjykuar krimet e luftës në Kosovë, që të ndahet buxhet i mjaftueshëm, sepse ato lëndë dhe ato të cilat janë të gatshme për t'u ngritur aktakuzat, unë nuk besoj që ka deputetë këtu që është i gatshëm të bllokojë një iniciativë të tillë. Prandaj, ju lus në emër të Nismës Socialdemokrate të lëvizim përpara. Mundësia është këtu të marrim prej të gjithëve ngapak dhe ta bëjmë një të përbashkët. Faleminderit!

KRYETARI: Ahmet Isufi dhe përfundon. Faton, idenë ta kemi votuar, tash e ke dhënë një zgjidhje të mesme, shumë të mirë. Ahmet Isufi, pastaj edhe ministri i Drejtësisë edhe përfundon.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara familje të të pagjeturve prezentë në këtë sallë,

Unë mendoj që duhet shkurt t'i biem kësaj pune, sepse ne e kemi votuar një rezolutë. Rezolutë mbi rezolutë nuk mund të votojmë, sepse për të njëjtën çështje të votojmë rezoluta të vazhdueshme. Secili grup mund të ofrojë, po ashtu nuk bën. Konsideroj që një rezolutë është votuar. Komisioni tani është propozuar. Është rezoluta për gjenocidin serb të kryer në Kosovë dhe ky Komision i cili është propozuar tani, u votua që të shkohet më tutje, të formohet Komisioni dhe të vazhdojmë punën.

Dhe për atë se a jemi vonuar a s'jemi vonuar, njëzet vjet jemi vonuar për këtë çështje, një tribunal duhet të krijohet. Janë modele të cilat kanë ndodhur edhe në vende të tjera, mund të merren parasysh, sepse gjykatat vendore dhe ato ndërkombëtare nuk mund të bien në kundërshtim kur ka çështje të cilat janë të njohura, janë të ditura, ka edhe eksperiencë në këtë drejtim, prandaj duhet të ecim më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Islami po insiston pa grup. Ismet kërkoj falje, po e bëj lëshimin, pastaj duhet të gjithëve t'ua jap. Tash, po ju jepet veç kryetarëve të grupit. Islam të lutem pasi në emër të pagrupëve.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Kolegë të nderuar,

Mysafirë, familjarë që jeni këtu sot,

Ju them shumë sinqerisht, unë desha jo të komentojë rreth kësaj, vetëm të shprehë zhgënjimin tim brenda këtij Parlamenti, që qe nga dita e parë që i propozua e deri më sot, jemi veç kush po merr bajrak. Pse nuk mundemi ne të japim një propozim të përbashkët e të mos kemi, veç për çështje bajraku, qysh të marrim elektoratin, po ne nuk jemi duke vepruar, duke e bërë punën. Ne sot jemi këtu për të themeluar diçka, ne duhet ta themelojmë. Përndryshe, unë mendoj që qytetarët nuk janë kaq të pashkollë mos të na kuptojnë neve çka po bëjmë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet po insiston dhe po më vjen keq, për besë jeni duke më abuzuar edhe ju mua. Hajde Ismet! Hajt pasi po insiston. Fatoni erdhi prej atje lart po dëshiron të gjejmë njëfarë konsensusi, pasi ka kaluar iniciativa. Armend s'mund t'jua jap të gjithëve për besë, edhe shkojmë drejt e në seancë.

ISMET BEQIRI: Më lejo në emër të Grupit, në konsultim dhe me kryetarin e Grupit. Unë kam një propozim, meqenëse ka vullnet që të gjithëve, edhe vërtet kjo formë, kjo qasje, këto diskutime nuk na bëjnë nderë askujt, kishte gatishmëri të të gjitha grupeve, ne pajtohemi që formohet ky Komision që u propozua nga PSD-ja. Po e japim të gjithë nga një përfaqësues në këtë grup, le të dalin ta harmonizojnë tekstin, edhe e votojmë. Kjo është e thjeshtë. Ne pajtohemi që ta kemi një përfaqësues në atë komision, që e tha PSD-ja, u miratua, PSDK-ja, po. Edhe të vijmë pastaj pas pauzës të harmonizohet teksti dhe të vihet me një rezolutë edhe ta votojmë në Kuvend. Kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri edhe shkojmë drejt, me aq. I nderuar Ismet, do të thotë se s'po e vejmë në votim rezolutën. Vetëm pak ministër, të lutem! Ismetit, regjia vetëm pak fjalën. Urdhëro edhe një herë Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Unë e thashë shumë qartë, nuk kemi nevojë më të votojmë diçka. Ne Komisionin që u votua po e dërgojmë nga një përfaqësues secili grup parlamentar, le të tërhiqen, të harmonizohet teksti dhe vjen një tekst i përbashkët i të gjitha grupeve edhe e votojmë. Kjo është ajo.

KRYETARI: U krye. Faleminderit! Shumë, shumë qartë. Ministër, çka ka për të qartësuar proceduralisht dhe shkojmë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që është e padrejtë që prej deputetit të krahasohet Gjykata Speciale me kërkesën e Republikës së Kosovës me Tribunalin Ndërkombëtar. Prisni dy minuta! Ne e dimë të gjithë se me çfarë presioni edhe me çfarë kërkesë edhe prej çfarë raporti është krijuar Gjykata Speciale.

U tha që për 4 vite nuk është ngritur asnjë aktakuzë, jo për 4, po besoj që edhe për 40 do të kenë problem të evidentojnë dhe të nxjerrin në pah krimet që i paska kryer UÇK-ja ndaj popullatës civile serbe. Pra, kurrë nuk do të arrijnë të dëshmojnë dhe të faktojnë një të tillë.

Në anën tjetër, mendoj që është edhe njëlloj mbulose e faktorit ndërkombëtar që t'i mbulojë dështimet e tij për 15 vjet sa kanë qëndruar në Kosovë dhe nuk arritën që t'i dëshmojë këto krime që i kemi kryer ndaj popullatës civile serbe.

Ne jemi që të gjithë ata që kanë kryer krime, kushdo që ka kryer krime ndaj civilëve, ndaj cilitdo nacionalitet të dalë para drejtësisë, mirëpo sot është e papranueshme që Republika e Kosovës të mos i drejtohet Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Sigurimit, drejtësisë ndërkombëtare, për 13 547 viktima që kanë ndodhur në Republikën e Kosovës.

Pra, është e drejtë e jona. Në fund të fundit edhe nuk e bëjmë, le ta njohë historia kërkesën e Republikës së Kosovës për të këtë të drejtë tonën.

Ne e shohim sot edhe Armeninë, e cila edhe pas 100 vjetëve i kërkon të drejtat e saj. Pra, për luftën e cila ka ndodhur qysh pra 10 vjetëve.

Nuk dua të krijoj ndonjë incident diplomatik këtu, mirëpo është e drejtë e jona dhe ajo duhet të ndodhë. Nuk duhet ta krahasojmë Gjykatën Speciale me Tribunalin për të cilin ne si institucione kërkojmë të krijohet për ato 13 547 viktima që kanë ndodhur në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi, ma jep emrin e anëtarit të komisionit. Të shkojmë drejtpërdrejt. I lutem të gjitha grupeve parlamentare, meqë e kanë marrë fjalë... Po kërkonti replikë? Në rregull zoti Kurti, meqë kur t'ju përmendet emri juve...

ALBIN KURTI: Së pari, unë vetëm e mora si shembull Gjykatën Speciale, të cilën unë e kam kundërshtuar, për dallim prej kolegëve tuaj. Dhe kjo ka qenë më 3 gusht të vitit 2015.

Si shembull i kohëzgjatjes tejet të madhe, tribunalet ndërkombëtare prej kohës kur themelohen e deri kur t'ia nisin që të funksionojnë, kjo i hanë shumë vjet. Ne nuk kemi kohë, se po vdesin dëshmitarët.

Prandaj, si bëhet që po na ngutet për Tribunal Ndërkombëtar e nuk po na ngutet që ta votojmë në lexim të dytë, plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që tua mundësojmë prokurorëve tanë që t'u gjykojnë e t'i dënojnë në mungesë kriminelët serbë.

Pra, po na ngutet për diçka që i merr shumë vjet, e s'po na ngutet për diçka që mund të veprojmë menjëherë, e para. E dyta, ministri tha diçka, për mua vendimtare, tha që edhe nëse nuk e bëjnë ata Tribunalin, neve na e njeh historia.

Pra, kjo tregon që ministri i Drejtësisë është përgatitur për dështim. Ky tha që edhe nëse nuk e bëjmë, rri letra jonë atje dhe neve na e njeh historia. Pra, nuk e ke te drejtësia. Nuk e ke as te reparacioni as te retrobuimi i aspektit të drejtësisë për viktimat e luftës sonë.

Pra, ju veçse jeni përgatitur që ndoshta nuk bëhet ky Tribunal. E kur ju jeni gati në fillim që ndoshta nuk bëhet ky Tribunal, mund ta merrni me mend sesi i vjen fundi. Pra, ju jeni të përgatitur për dështim, prandaj po them se, është e domosdoshme që ta padisim Serbinë, duke u përgatitur mirë, në GjND për gjenocid në njërin anë dhe në anën tjetër, ta bëjmë plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale për ta mundësuar gjykimin në mungesë.

Dhe, krejt në fund, unë nuk mendoj që kjo është vetëm çështje e vullnetit, është çështje e dijes. Pa e lexuar se çfarë ka shkruar Furtuna Sheremeti dhe Robert Muharremi, nuk është mirë që ta merrni fjalën sot këtu. Është çështje dijesh dhe jo vetëm e vullnetit.

KRYETARI: Kundër-replikë edhe shkojmë vazhdojmë pastaj. Daut, në qoftë se njërit ia jap fjalën, pastaj duhet tua jap edhe 5 deputetëve, pastaj e gjithë koha na shkon këtu.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Fakti që nuk është në dorën tonë krijimi i këtij Tribunali, mirëpo të në duart e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kjo edhe mund të ndodhë, ngase nuk varet nga vullneti ynë.

Vullneti ynë është që të kemi drejtësi ndërkombëtare, ashtu siç ka pasur edhe për qytetarët e Bosnjës, të Kroacisë e kështu me radhë. Pra, është kërkesë e jona si Republikë e Kosovës dhe nuk duhet t'i ndalemi kësaj kërkesë.

Po e them edhe njëherë, sa i përket Gjykatës Speciale ajo do ta ketë shumë problem që t'i faktojë, t'i dëshmojë krimet që kinse i ka kryer Ushtria Çlirimtare ndaj popullatës civile serbe.

Pra, kjo s'ka ndodhur për 15 vjet sa kanë gjurmuar në Kosovë edhe UNMIK-u edhe EULEX-i. Edhe tani s'ka ndodhur për katër vjet, dhe s'besoj se do të ndodhë edhe për 40 vjetët e ardhshme.

Ne jemi të përgatitur dhe e dimë se çfarë po duam, dhe do t'i shkojmë deri në fund. Pavarësisht tendencës suaj, që të zvarritet, të bllokohet dhe të ndalet ky proces. Nuk mundesh. Nuk mundesh.

KRYETARI: Memli, ma jep të lutem anëtarin e komisionit.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Fillimisht e përshëndes këtë hap pozitiv, i cili shpresoj se e kthen në drejtim të mirë, dhe përtej protagonizmave të secilit.

Unë mendoj që do të ishte mirë që, ndoshta për t'i dhënë një relevancë, të jenë kryetarët e grupeve parlamentare, anëtarë të këtij komisioni. Nuk patëm kohë të diskutojmë me kolegë, ose sido që ta vlerësojnë ata, por sidoqoftë, nëse ka vullnet prej të tjerëve, atëherë unë e propozoj vetveten, pra që ta përfaqësoj PDK-në në këtë komision.

KRYETARI: Faleminderit! Avdullah Hoti, ju lutem! Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Unë nuk mendoj që kjo është çështje politike që duhet të kenë përfaqësuesit më të lartë të grupeve parlamentare.

Këtu duhet të jenë njerëz që e kuptojnë këtë çështje. Që i njohin edhe ligjet vendore edhe ndërkombëtare, prandaj ne propozojmë Vjosa Osmanin.

KRYETARI: Dikush nga Lëvizja Vetëvendosje, ju lutem! Zoti Konjufca, urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Para se ta bëj propozimin më duhet ta bëj një elaborim. S'kam qare, meqë dua t'i kontribuoj kësaj sesi të dilet prej situatës me argumente dhe pa kurrfarë ngarkesash politike.

Kjo, sepse tema është e ndjeshme dhe i kemi këtu edhe përfaqësuesit e familjarëve të të pagjeturve.

Kështu që sa i përket kësaj që e propozoi Fatoni, unë në të vërtetë e kuptova këtë si një lloj propozimi që, duke e pasur parasysh faktin se prej grupeve të ndryshme parlamentare patëm ide të ndryshme, atëherë do të ishte më së miri që të vijmë deri te një dokument, i cili prodhohet në formë të qëllimeve dhe të mandatit që do ta ketë grupi, i cili krijohet nën autoritetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo është shumë mirë dhe kjo mund të bëhet.

Ma merr mendja që ky është njëfarëlloj instruksioni para se të arrihet deri te ai grup, i cili do t'i definojë qëllimet e veta dhe fushëveprimin.

E dyta...

KRYETARI: Kryetar i grupit, me fal vetëm se pse këto çështje nuk po i theksoni kur të takoheni edhe pastaj na jepni një mundësi. Ndryshe, tani jemi në fazën e marrjes së emrave dhe e kemi mbajtur një seancë për diskutime. E mbajtëm edhe të dytën. I humbëm 1 orë e gjysmë.

Ju kisha lutur, në qoftë se mundesh të mos na maltretoni. Shkoni e pastaj bisedoni. Unë nuk jam kundër idesë asgjë, vetëm se kur të shkoni në komision, pastaj i theksoni të gjitha këto edhe na ndihmoni edhe neve në seancë.

GLAUK KONJUFCA: Jo, meqë ne nuk po pajtohemi edhe ju po e kuptoni ndryshe se çfarë ka ndodhur, dhe unë jam duke e kuptuar ndryshe se çfarë është duke ndodhur.

Faktikisht, që ta shpjegoj saktë edhe që të mbetet kjo e shkruar edhe në dokumente të Kuvendit, unë po mendoj që përfaqësuesit ku do t'i dërgojmë, nuk do të jenë të një komisioni.

Aty me 61 vota të Kuvendit të Kosovës, pak më parë nuk është krijuar kurrfarë komisioni. Aty është hedhur vetëm një ide që ne t'i dërgojmë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ashtu që të tregojnë saktë se cila do të jenë qëllimet, mandati dhe fushëveprimi i një komisioni... Jo, nuk po e dimë.

Dëgjo, këtu është gabimi, sepse çka do të hedhet në votim nëse do të krijohet një komision...

KRYETARI: Glauk, do t'ju lusja që për hir të respektit publik edhe seancës. Shkoni në komision...

GLAUK KONJUFCA: Ju na e keni dërguar, ne e kemi vetëm një dokument që ju na e keni dërguar si propozim për...

KRYETARI: O Glauk, po ai nuk do të vinte pa pasur dokument edhe 20 vjet të tjera në seancë, pa e sjellë ndonjë qenie njerëzore, deputet.

GLAUK KONJUFCA: Dëgjo, aty ka defekte elementare në atë dokument që e keni sjellë.

KRYETARI: Glauk, shkoni dhe bisedojeni në komision, të lutem!

GLAUK KONJUFCA: Vetëm për ta specifikuar. Ky që u themelua tani, ku po i dërgojmë ne njerëzit nuk është komision. Kjo të kuptohet. Edhe kuptojeni të gjithë në këtë Kuvend.

Pra, ky është vendim i rëndësishëm profesional ky, nuk është...Pse po e them këtë? Sepse këtë grupin fillestar, i cili do t'i japë ato instruksione edhe qëllime, ne do ta dërgojmë Sami Kurteshin, mirëpo kur të kthehemi këtu dhe do ta votojmë komisionin i cili do të merret me këtë problematikë specifike, do ta dërgojmë Albulena Haxhiu, për shembull.

Vetëm se duhet ditur që të bëhet dallimi, sepse nuk është bash shaka kjo, është shumë e rëndësishme.

KRYETARI: Këto janë procese dhe s'prish punë. Sami Kurteshi është i propozuar. Shkojmë tek zotëri Isufi i cili do të na e jep propozimin. Dauti do të na e japë. Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Meqë më herët s'ma dhe fjalën, tani po e shfrytëzoj edhe unë të drejtën time.

Të gjithë po pajtohemi që ka pasur krime, dhe ne e kemi kaluar një rezolutë javën e kaluar, e cila e dënon gjenocidin serb në Kosovë. Ndërsa, këtu me sa e di unë, të gjithë anëtarët në komision kanë qenë shumë unik në hartimin e asaj draft-rezolute.

Edhe sot të gjithë po pajtohemi që krimet duhet të gjykohen, po pyetja është se; a më përpara të ndërtohet hekurudha apo treni?

Kështu që, ne t'i çojmë përfaqësuesit tanë si anëtarë komisioni, dhe pastaj ai komision vjen me propozime dhe ne do të votojmë. Në këtë rast, ne e propozojmë Muharrem Nitajn.

KRYETARI: Faleminderit! PSD-ja, ju lutem! Po, Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Po, ne e votuam në fakt komisionin dhe vetëm për sqarim, ajo që e propozova unë, është që t'i harmonizojmë qëndrimet dhe po mendoj se me këtë e tash thelbin e asaj.

Kjo nënkupton tekstin, pastaj hapat që do të ndërmerren, e kështu me radhë.

Ne nga Partia Socialdemokrate, propozojmë Dardan Molliqajn që të jetë pjesë e këtij komisioni.

KRYETARI: Faleminderit! Nga PSD-ja do të jetë Dardan Molliqaj. Zoti Sherifi nga Nisma e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Nismës do të jetë deputeti Enver Hoti.

KRYETARI: Nga 6+, fjalën e ka Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar! Grupi Parlamentar 6+, propozon deputeten Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit! A ka mundësi një votim formal, kush është kundër? Votojmë me dorë. S'ka kundër. Tash vetëm në aspektin teknik. A e vazhdojmë seancën deri në pauzë të shkojmë me votime, dhe pastaj komisioni shkon në pauzë dhe gjatë kohës së pauzës edhe e mban takimin.

Shkojmë në votime.

Jemi te pikat e rendit të ditë 2, 3, 4 të ndërlidhura këto; Muzeu i Gjenocidit, Memoriali i Dëbimit dhe Dita e Gjenocidit. Këto janë pikat.

A do të ketë në Kosovë Muze të Gjenocidit apo jo? Memoriali i Dëbimit dhe Dita e Gjenocidit.

A dëshironi edhe këtë ta vëni në diskutim? Urdhëro, zotëri Hoti. Vetëm pak, më falni! Jemi duke folur për diçka që është pikë e rendit të ditës. Unë e sjell në Kuvend të Republikës së Kosovës te deputetët, dhe deputetët vendosin pastaj sesi duan që ta drejtojnë. Urdhëro, zotëri Hoti.

AVDULLAH HOTI: Duke qenë se u arrit një dakordim për një rezolutë që duhet të vijë në Kuvend sa më shpejt, ne komisioni ose grupi punues që u themelua, i cili do t'i shqyrtojë pra në atë rezolutë hapat që duhet ndjekur për ta dënuar krimin dhe gjenocidin e shtetit serb në Kosovë, unë propozoj që pika 2,3 dhe 4 të shqyrtohen në atë rezolutë.

Pastaj t'i propozohet Kuvendit sesi të procedohet.

KRYETARI: Është legjitime. Ne jemi para qytetarëve. Pra, nuk duhet që të sillet këtu. Ky është propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së që edhe kjo të largohet dhe të shkohet me...

AVDULLAH HOTI: Arsyeja pse po e them këtë, është se pikat 2 dhe 3 nuk janë në fushëveprimtarinë e Kuvendit, kryetar.

KRYETARI: S'janë në fushëveprimtarinë e Kuvendit!

AVDULLAH HOTI: Besoj që Sekretari duhet t'ju informojë që Kuvendi i Kosovës, nuk merr vendime të tilla, por mund të parashihen në rezolutën e cila vjen në Kuvend. Pra, kjo rezolutë duhet t'i parashohë hapat konkretë lidhur me hapat e tjerë që duhet të ndërmerren për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit, Memorialit të Dëbimit, po ashtu edhe përcaktimin e Ditës së Gjenocidit.

Besoj kjo është forma më e mirë për ta realizuar këtë.

KRYETARI: Zoti Hoti, do të jem shumë i drejtpërdrejtë. Unë po e kuptoj qartësisht, pasi është emri im, largojeni. Kuvendi i Republikës së Kosovës merret edhe me trajtimin e ujërave të zeza, edhe me kanalizime, i nderuar kryetar i Grupit Parlamentar, ish-ministër i Financave.

Kuvendi i Republikës së Kosovës e voton çdo buxhet, e autorizon Qeverinë, njëjtë e keni edhe këtu. Ja ku e keni, pika katër. "Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi". Po ju e vendosni, bile mua po më kënaq kjo farë situatë për të parë popullin se në çfarë gjendje jemi. Po më vjen shumë mirë. Propozimi është konkret, unë e nxjerr në votim, s'e kam ndërmend ta maltretoj Kuvendin, të mos hapim debat, ju lutem. Jo, se po hapet debat.

Urdhëro, zoti Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Ne veç sa arritëm një konsensus, një pajtueshmëri, që është për t'u përshëndetur, se fatkeqësisht nuk po na ndodh shpesh në Kuvend, kjo ishte për pikën e parë.

Për pikën 2 dhe 3 janë disa propozime, për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit edhe Memorialit të Dëbimit.

Ajo që tha zoti Hoti, a është a s'është në kompetencën tonë, ne shumë thjesht ma merr mendja mund të themi që kompetenca Kuvendi i Kosovës u jep të tjerëve përmes ligjeve dhe vendimeve të veta. Domethënë, edhe ata që mund ta kenë kompetencë, e kanë se ne ua kemi dhënë atë kompetencë, sepse kemi miratuar një ligj për atë punë.

Edhe një kompetencë të tillë, në raste të caktuara, nëse duam, mund t'ia japim edhe vetvetes, e sidomos për një çështje të tillë.

Po nëse ju ndiheni singërisht të shqetësuar që procedurat nuk qenkan në rregull, ne mund të themi që e propozojmë ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit në këtë vend dhe në pikën dy themi që kërkojmë nga autoritetet përgjegjëse që ta përgatisë këtë edhe atë. Ta zëmë, ish-Fabrika e Tjegullave në Prishtinë, nëse nuk gaboj është nën menaxhimin e Agjencisë të Privatizimit të Kosovës. Jo është, me letra është, Dardan, merre fjalën e mos bërtit nga mbrapa.

Po këtu kemi të bëjmë me dy çështje, me vullnet, shikoni nëse përnjëmend doni ta hiqni, nuk ka problem, ju tha njeriu, Kadri Veseli, si kryetar i Kuvendit tha hiqni, prishni dokumentin, sekretar, prishni krejt dokumentacionin çka keni sjellë që e ka propozuar Kadri Veseli, aman, veç t'i votojmë edhe këto pika, të cilat janë simbolike. Ku doni ta bëni tjetërkund Muze të Dëbimit të qindra-mijëra shqiptarëve nëse jo te Stacioni i trenit, ku janë dëbuar shumica e qytetarëve të Prishtinës dhe rrethit.

Ani, mirë, Sarandë, që paska qenë kjo ide, votoje pra, a e ke dhënë ti aty, po ta lëmë idenë, aman veç votojeni. Kushdo që keni dhënë idenë, dilni dhe po ua qesim edhe emrat që ideja ka qenë e filanit, veç ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit!

A të shkojmë në votim apo, Dardan, vetëm për korrektësi. Merre fjalën, ndoshta është mirë në çështjen që u diskutua, keni mundur edhe para se të vini në seancë, po mund ta diskutojmë, Agjencia Kosovare e Privatizimit i jep përgjegjësi Kuvendit, kam biseduar me ta, i di procedurat për Komunën e Prishtinës, e di se nuk ka përfunduar ende, nuk janë bërë as pagesat që janë dashur, të jeni të sigurt se nuk është bërë diçka kundërligjore dhe jo në autoritetin e Kuvendit, po si do që të jetë, fjala është për ju. Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Në disa rrafshë po e trajtoj këtë çështje.

E para mendoj që situatën në pikën paraprake duhet ta mirëpërdorim. Pra, e kemi një komision të votuar, i cili të gjitha temat që ndërlidhen me çështjen në fjalë i trajton dhe i koordinon me institucionet përkatëse. Pra, është një koordinim i mirëfilltë i subjekteve në Kuvend njëzëri dhe nuk i bëjmë nderë temës përsëri duke hyrë në këto diskutime, për të cilat as nuk e kemi informacionin e plotë, as nuk e kemi kompetencën profesionale për të vendosur.

Pra, një është informacion procedural juridik dhe tjetra është kompetencë e natyrës historike, e natyrës arkitektonike, urbaniste, e tjera, e tjera. Ne nuk i kemi, gjithsecili i kemi preferencat se ku mund të jetë një temë e tillë, gjithkush e ka një ide.

Unë besoj që Komisioni në punën e vet mund të definojë se si të bashkërendohen këto punë që të vijjnë me propozime të mira, të sakta e ndodh edhe këto, nuk e di, po s'po dua të paragjykoj.

Ajo çka është me rëndësi në aspektin procedural e ligjor, dhe për hir të opinionit po e bëj këtë, Komuna e Prishtinës ka paguar transhin e parë të parave për bartje të kësaj prone dhe kjo procedurë ka filluar vitin e kaluar. Tash, nuk e kam unë hallin a është ky pozicion apo jo, por të jemi të saktë, të qartë e të sigurt juridikisht, proceduralisht.

Në anën tjetër, edhe në aspekt të kompetencës, me gjithë respektin për kryetarin e Kuvendit, me gjithë respektin për Zyrën Ligjore edhe të AKP-së, edhe të Kuvendit. Mendoj që lokacioni duhet të përcaktohet nga njerëz që merren me temën në baza të përditshme dhe kjo na bënë edhe nder, sepse nuk është lokacion i cili është për nesër aspo për sot. Është duke u shenjuar diçka në histori dhe merita të jenë edhe të Sarandës, edhe tuajat, kryetar, po në të ardhmen vendi do të jetë i gjeneratave, e jo as juaji, as imi, as i Memlit dhe këtu pajtohem plotësisht.

Rrjedhimisht propozimi im konkret është që: Këto tema pikën 3, 2, dhe 4 t'ia lëmë Komisionit në punë të përbashkët të subjekteve dhe të mos e elaborojmë tutje, sepse nuk i bëjmë nder diskutimit. Faleminderit! Pra, jem në pajtim me zotin Hoti në këtë drejtim.

KRYETARI: Kjo është situata reale, në të cilën është vendi ynë. Sido që të jetë, pasqyra më e mirë për qytetarët të dinë në çfarë gjendje jemi është kjo, çka po ndodh në këto dy javë.

Kështu vendimmarrje nuk mund të marrë askush, pos seancës. Këto kanë qenë pika të cilat janë radhitur me vendimin e Kryesisë, ju lutem, s'do ta bëjmë garë. Pikat janë të renditura nga Kryesia e Kuvendit, nxirrni në votim, keni një propozim konkret, vetëm pak, keni një propozim konkret.

Pikat 2, 3 dhe 4 të barten, të largohen, cila është katërshi, 1, 2, 3, vetëm pak, më falni. Protokoli m'i ka shkruar pika 2, 3, dhe 4, edhe pastaj konstatojnë, një është Muzeu i gjenocidit, dy është Memoriali i dëbimit dhe tre është Dita e gjenocidit.

Propozimi, me aq sa po e shoh nga reagimet, është që pavarësisht se ngarkohet edhe katërshi, ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i ndër marrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi dhe pesëshi, ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Do të thotë, të gjitha këto pesë vendime, vetëm pak. Ideja është që sot të mos vihen në votim, ka një propozim të barten te Komisioni, seanca e vendos. A ka mundësi ta bëj kështu dhe të mos e komplikojmë situatën.

Nait, të lutem, po shkojmë në votim.

Nait, a ka të bëjë me procedurë të votimit... Burgun e Prishtinës, pastaj vazhdoni, kreativitetin dhe protagonizmin e vazhdojmë në rrethana të tjera, të ndalemi një herë këtu.

Përgatituni për votim, votojmë tash!

Njëjtë, kalojnë edhe këto pika të rendit të ditës, më tutje janë pjesë e Komisionit.

II. Shqyrtimi i Propozim-Amendamentit numër 26 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Sa deputetë i kemi, sa deputetë janë prezentë në sallë? 94 deputetë janë në sallë.

Ju lutem, nuk mund ta vëmë në votim, për faktin se duhet 2/3 e komuniteteve.

Shkojmë në pikat e papërfunduara nga seanca plenare e mbajtur më 7 mars 2019.

Ju njoftoj se diskutimet për pikat e rendit të ditës 1, 20, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 34 dhe 35 kanë përfunduar në seancat plenare të mëparshme.

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 25 amendamente dhe dy amendamente nga Komisioni Funkcional dhe dy amendamente nga deputetët, pra amendamenti 7 dhe 16, do të votojmë të gjitha propozimet, 25 amendamente nga Komisioni Funkcional.

Do të thotë, keni parasysh, amendamentet 7 dhe 16 nuk votohen. A ka reagim të votojmë me dorë.

Urdhëro, zoti Ymeri, fjala për ju!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj ndjesë që pak me vonesë, mirëpo e kemi një çështje, e cila e ka një urgjencë në të.

Ne si Komision Hetimor për hetimin e gjendjes në PTK dhe Vala tash e sa muaj punojmë pa buxhet të miratuar dhe kjo po na shkakton goxha probleme logjistike në punën tonë si komision.

Ne në mbledhjen e fundit të komisionit me dakordancë të të gjithë anëtarëve kemi vendosur që ta bëjmë sot si kërkesë që ta fusim në rend dite dhe ta votojmë buxhetin për komisionin, i cili ka kaluar nëpër Kryesi, po është bartur që të votohet në njërin prej seancave. Vërtet e kemi një situatë në të cilën nuk po mund të funksionojmë më pa buxhet për shkak të disa specifikave që i ka komisioni, veçanërisht në intervistimin e dëshmitarëve, dhe në këtë drejtim kisha kërkuar edhe nga seanca, edhe nga ju, që ta vendosim si pikë të rendit të ditës dhe ta votojmë këtë buxhet.

Kam besimin që të gjitha grupet parlamentare janë dakord, meqë përfaqësuesit e tyre në komision të gjithë kanë qenë dakord që kjo të votohet sot.

Pra, ky është mocioni ynë që ta fusim si pikë e rendit të ditës mbase në fillim të seancës, meqenëse kjo nuk është një pikë e rendit të ditës ku ka ndonjë diskutim dhe rrjedhimisht ta votojmë, e pastaj të vazhdojmë tutje me pika të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Unë do ta nxjerr në mënyrë formale, si mocion procedural, pastaj ndërkohë do ta fusim edhe pikë të rendit të ditës edhe këtë çështje.

A të shkojmë në mënyrë formale, të mos shkojmë me votim elektronik, është sensitive, do përkrahjen e Kuvendit.

A ka dikush kundër? Nuk ka kundër, Abstenim, nuk ka. Aprovohet.

Futet pikë e rendit të ditës në votime tani.

Jemi në votimin e amendamenteve nga 1 deri në 27 janë në fakt, po largohen vetëm 7 dhe 16, votohen ndaras. Këto janë 25 amendamente të propozuara të gjitha bashkërisht nga Komisioni Funkcional.

A është dikush kundër? A ka abstenim? Dëshironi në mënyrë elektronike?

Amendamentet 1 deri në 27, largohen amendamentet 7 dhe 16. A mund ta kem korrektësinë për votim elektronik, të gjitha bashkërisht me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë në mënyrë elektronike 27 amendamente, pa 7 dhe 16, të cilat do të votohen ndaras. Votimi vlen për të gjitha ato të cilat janë përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL dhe kanë ardhur në votim, votojmë tash!

Janë 59 deputetë që kanë votuar, nuk ka kuorum e nevojshëm.

Thërras deputetët të kthehen në sallë, në qoftë se dëshirojnë të votojnë për faktin se janë diku 94 ose 96 deputetët të nënshkruar, gjersa në sallë kanë votuar vetëm 59, do të thotë 95 deputetë janë nënshkruar për mëditje, kjo është realiteti.

A ka mundësi të votojmë edhe një herë. Votojmë edhe një herë sipas traditës.

Të nderuar deputetë,
Të përgatiteni për votim, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 61 vota janë për, votohen 25 amendamente. Tani shkojmë në mënyrë specifike te amendamenti 7.

Amendamenti 7

Propozimi i deputetes Shqipe Pantina, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Nuk e ka kërkuar fjalën, zoti Krasniqi, unë s'mund t'ia jap fjalën pa e kërkuar.

Zonja Pantina për amendamentin 7, edhe një herë para votimit përfundimtar.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Atëherë po, ka kaluar një kohë e gjatë, vetëm shkurt ta shpjegoj se çka ka të bëjë amendamenti.

Të gjithë prindërit, të cilët janë të vetëm, ngase u ka vdekur bashkëshorti, bashkëshortja apo për arsye të tjera janë mbajtës të vetëm të familjes, të lirohen nga tatimi në të ardhura personale. Kjo është një praktikë në shumicën e vendeve të BE-së. Natyrisht se Ministria e Financave mandej duhet t'i evidentojë, sepse këta njerëz duhet ta evidentojnë se janë të vetëm, është lirimi nga tatimi në të ardhura personale derisa këta e kanë këtë status, pra janë prindër të vetëm si mbajtës të familjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamenti 7

Propozimi i deputetes Shqipe Pantina, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!
Faleminderit!

Në rrethana të tilla, edhe projektligjin duhet ta mbajë anash, për faktin se s'mund të procedojmë më tej derisa nuk kemi votim.

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Janë gjithsej 24 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL dhe një amendament nga deputeti, amendamenti 5.

Unë prapë, edhe këtu do të shkoj në votimin e 24 amendamenteve, të cilat i vë në votim në rend të parë vetëm ato të cilat janë të përkrahura nga Komisioni FunkSIONAL, jo edhe të tjerat.

Votojmë tash!

Janë 59 deputetë. Unë do ta vë edhe një herë në votim. Janë 24 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL, të cilat do të votohen edhe një herë, votohen në tërësi të gjitha bashkërisht.

I falënderoj familjarët e personave, të cilët më së shumti kanë vuajtur gjatë këtyre 20 vjetëve për prezencën e tyre, po e shoh janë duke lëshuar seancën, faleminderit shumë!

24 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 61 për, një abstenim.

Amendamenti 5

Propozimi i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zoti Haxhiu, a e dëshironi fjalën? Urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Ky është një amendament, për çka kërkoj përkrahjen tuaj, ka të bëjë me zbritjet e lejuara për aktivitetet në interes publik në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me qëllim që të jetë i harmonizuar me Ligjin numër 05/L-090 për sponsorizimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, i cili ka hyrë në fuqi më 19. 1. 2017, por që nuk ka gjetur implementim për shkak të mosharmonizimit me Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Prandaj, kjo është një mundësi e mirë që me votimin e këtij amendamenti të harmonizohen këto dy ligje dhe më në fund sportdashësve, sponsorizuesve dhe donatorëve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit t'u hapet rruga që të mbështesin sportin dhe kulturën në Kosovë.

Prandaj, është një punë të cilën e kanë bërë edhe në mandatin e kaluar edhe ish- ministrat, por e cila mund të harmonizohet sot me votën e deputetëve.

Pra, është në interes publik të të gjithë atyre që merren me sport. Prandaj, kërkoj vëmendje dhe mbështetjen tuaj për këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Patëm arsyetimin e deputetit, shkojmë në votim, votojmë tash!

Për korrektësi, edhe ky ligj në qoftë se nuk votohet, unë edhe një herë do ta vë në votim, po në qoftë se nuk vjen në 61 vota, edhe ky mbetet anash, për faktin se s'mund të procedojmë projektligjin pa i votuar amendamentet.

Votojmë edhe një herë amendamentin 5 të propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, për, kundër, abstenim, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash:

Janë 60 deputetë, është afruar, a e vendosim edhe një herë në votim, nuk janë 61 apo?

Do ta vendos edhe një herë, pasi ishin 60 deputetë.

Amendamenti 5

Votojmë tash!

Edhe ky projektligj...

14. Votimi në parim i Projektligjit për peticione

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji.

Regjia, jemi te votimi në parim, kemi dalë te projektligjet.

Urdhëro, Bilall!

Regjia, koncentrimi do të jetë vetëm në projektligje.

Votimi në parim i Projektligjit për peticione, Bilall Sherifi, ndërkohë derisa regjia bëhet gati.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Kam një propozim për deputetët që kanë amendamentet. Po e shihni që nuk po arrijnë numrin e votave të kuorumit për të konstatuar se u votua. I lus që t'i tërheqin në funksion të kalimit të ligjeve, sepse nëse nuk bie apo nuk kalon një amendament, bllokohemi dhe nuk mund ta ecim ligjin përpara, ju lus. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetët Shqipe Pantina edhe Bekim Haxhiu, e keni fjalën, në qoftë se i tërhiqni, unë s'mund të insistoj, në qoftë se dëshironi fjalën për t'i tërhequr. Bekim Haxhiu, po e shoh.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar, respekt edhe për Bilallin, Po nuk mund të vazhdojmë t'u themi sponsorizuesve, donatorëve të sportit, ju lutem po e lëmë në amulli, kështu, qysh e kemi bërë një ligj për sponsorizim, jofunksional dhe duam të vazhdojmë jofunksional edhe tutje. Kjo nuk është në interesin e Bekim Haxhiut as të deputetëve të Parlamentit të Kosovës, është në interesin e zhvillimit të sportit.

Pavarësisht të gjitha partive politike, sepse të gjitha partitë politike në fushata po vrapojnë te sportistët të kërkojnë votën e tyre, ndërsa sot nuk e japin votën për zhvillimin e sportit, le të mbetet në ndërgjegjen e atyre që sot nuk po e votojnë këtë harmonizim të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Si lloj kundër-replike, zoti Sherifi, votojmë, se ky qëndrimi është ...

BILALL SHERIFI: Sa për sqarim, Bekim, unë votova për dhe jam për atë, por nuk mund ta detyrosh Kuvendin, nëse s'duan të votojnë. Prandaj, unë nuk besoj që po t'i pyesësh të gjithë ata sportdashës a je për ta bllokuar ligjin, sepse deputetët nuk po e votojnë këtë amendament, pa përkrahje të Komisionit Funkcional, nuk besoj që ata do të mbështesnin ty, edhe pse ti edhe unë përmes votës dhe 60 apo sa votuam e mbështetëm idenë.

Kjo ishte një lutje që të mos e bllokojmë ligjin, se a po e shihni çfarë vështirësish po kemi t'i bëjmë 61 deputetë në sallë që janë të gatshëm të votojnë. Pra, keni parasysht edhe këtë rrethanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

14. Votimi në parim i Projektligjit për peticione

Komisioni Funkcional ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar. 25 për. 39 kundër. 3 abstenime. Nuk kalon!

13. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji. Votojmë projektligjin, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim! Regjia, është pika e 13-të? Në qoftë se jemi ok, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 55 për. 1 kundër. 5 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/ L-097 për transmetuesin publik të Kosovës. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar. 64 për. 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin Nr. 06/L-128 për mbrojtjen nga zhurma. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Komisioni Funkcional ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash!

Ky është votimi aktual, votojmë edhe një herë! Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 54 për. 1 kundër. 6 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin Nr. 06/L-110 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

17. Votimi në parim i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Komisioni ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 57 për. 1 kundër. 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin Nr. 06/L-134 për tatimin mbi vlerën e shtuar. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

18. Votimi në parim i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar. 65 për. 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin Nr. 06/L-126 për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

20. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Për këtë projektligj janë propozuar gjithsej 55 amendamente. Ju lutem për vëmendje. Pika 20, regjia, vëmendje, tek amendamentet, të cilat do t'i votojmë menjëherë, do t'i vë në votim.

Amendamentet 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 14, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 55 vihen të gjitha në votim, se janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Pastaj amendamentet, të cilat janë propozuar ose nga deputetët ose nga grupet parlamentare, në qoftë se janë të një grupi parlamentar, i vendos bashkërisht ose të deputetit ndaras.

Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar. 61 për. 3 abstenime.

Kalojnë të gjitha amendamentet e përmendura.

Kisha pasur dëshirë të kemi vëmendjen! Janë disa amendamente të propozuara nga Lista serbe, ku janë në dualizëm me të Komisionit FunkSIONAL. Të gjitha ato, të cilat janë nga Lista serbe, edhe pse nuk janë prezentë, sa herë ka qenë ata, kanë pranuar të vihen të gjitha në pako. Unë do t'i vë në pako.

Amendamenti 4, janë dy propozime.

Unë do ta vë në rend të parë amendamentin 9 dhe 13, të cilat janë vetëm nga Lista serbe, në mënyrë elektronike, pasi nuk janë prezentë, votojmë tash!

59 deputetë kanë votuar. Duhet të votojmë edhe një herë!

Votojmë, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, janë amendamente të propozuara nga Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar. 3 për. 57 kundër. 7 abstenime.

Nuk kalojnë amendamentet e lartcekura.

Tani jemi te amendamentet 4 dhe 15, kemi propozimin e Komisionit FunkSIONAL, variantin A. Unë po i vë të dyja përnjëherë, pasi janë me propozim të Komisionit FunkSIONAL, pastaj e vë propozimin, variantin B të Listës serbe, cila fiton më shumë, kalon. Në mënyrë elektronike, po ashtu.

Amendamentet 4 dhe 15, propozim i Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar. 62 për. 2 abstenime.

Shkojmë te varianti B, në të dy amendamentet: 4 dhe 15, propozimi i Listës serbe, votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar. 3 për. 55 kundër. 5 abstenime.

Do të thotë kalon varianti A, i Komisionit FunkSIONAL.

Të gjitha amendamentet janë miratuar. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara, votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar. 60 për. 2 kundër. 4 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Janë amendamente, gjithsej 5, në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. I votojmë të gjitha përnjëherë.

Përgatitemi për votim, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 56 për. 5 abstenime.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

65 deputetë. Të gjithë kanë votuar për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-219 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë.

22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, janë tri amendamente. Të tri janë në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Jemi tek pika 22, regjia, kur jeni gati, shkojmë në votim.

I votojmë tash amendamentet!

65 deputetë kanë votuar. 62 për. 3 abstenime.

Kaluan tri amendamentet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar. 64 për. 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-047.

23. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Janë gjithsej 2 amendamente me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash në mënyrë elektronike!

64 deputetë kanë votuar. 64 për.

Kalojmë te votimi i projektligjit, pika 23: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat.

Faleminderit, administratën e kemi shumë profesionale, po edhe kështu desha ta vë në votim, e votojmë tash ligjin në tërësi!

64 deputetë kanë votuar. 63 për. 1 kundër.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat.

24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Janë gjithsej tri amendamente, të tri amendamentet janë rekomanduar për t'i votuar për. Votojmë tash në mënyrë elektronike!

Janë vetëm 55 deputetë, do ta vë në votim prapë.

Amendamentet 1, 2, 3 me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Kjo është vota aktuale, unë po e vë mënjane, për faktin se në fund do ta votojmë edhe një herë.

25. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Në këtë projektligj kemi vetëm një amendament të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL dhe Grupi Parlamentar 6+. E votojmë të Komisionit FunkSIONAL, pastaj variantin B po ashtu e vë në votim, në mënyrë elektronike.

Urdhëro, zoti Damka, po e shoh reagimin tuaj!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vetëm të arsyetoj amendamentin e Grupit 6+. Te neni 4, paragrafi 2 të Projektligjit për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, kur flitet për nenin 20 të Ligjit bazik, të paragrafi 5, të hiqet fjala “objektet e kultit”, të formulohet si në vijim: “Objektet përcjellëse administrative faturohen në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse faturohet sipas tarifës për konsumatorë komercialë industrialë”. Për arsye se objektet e kultit janë objekte publike dhe shfrytëzohen në të mirat e përgjithshme të qytetarëve. Nuk financohen nga shteti, as nga ndonjë burim tjetër publik, privat.

Prandaj, nuk ka burim financiar për mbulimin e pagimit të shpenzimeve të ujit të shpenzuar nga xhemati në rastin e kryerjes së ceremonive. Shfrytëzimi i ujit për kryerjen e ceremonive fetare është e domosdoshme në të gjitha objektet e kultit në Kosovë. Mungesa e ujit do të pamundësonte kryerjen e ceremonisë fetare dhe objektet e kultit nuk do të mund të shfrytëzohen për qëllim të këtyre të destinuar. Të mos përmend edhe në vitet e '90-a kur këto xhami i kanë hapur dyert për shkollimin e fëmijëve tonë, e deri tani asnjëherë nuk u kemi dalë përballë t'i ndihmojmë as këto xhami, as kishat, as të tjerat. Prandaj, kërkojmë të përkrahni amendamentin e Grupit 6+, siç është deri tani, të lirojmë prapë pagesën e ujit vetëm për objektet e kultit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Propozimi i 6+ u theksua, tani unë shkoj në votim.

Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash në mënyrë elektronike.

Janë dy propozime, po e shoh, pritni pak, deputetë, të ndalet votimi, se po shoh reagim. Jemi te Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, ju lutem koncentrim. Është vetëm një amendament, me dy propozime. Amendamenti është i Komisionit FunkSIONAL, varianti A, të cilin e vë në votim dhe amendamenti B, ajo që e tha Fikrim Damka. Tash votoni për njërin prej tyre.

Do të thotë, e votojmë të komisionit në rend të parë, varianti A. Varianti B është i 6+, cili merr vota më shumë, kalon, ta keni parasysh.

Votojmë në rend të parë për variantin A, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 29 për. 23 kundër. 9 abstenime.

Tani jemi te propozimi i Fikrim Damkës, i emblemuar për 6+. Votojmë tash për amendamentin, variantin B!

62 vota. 54 për.

Do të thotë kalon amendamenti i 6+.

Shkojmë në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara, votojmë tash!

59 deputetë kanë votuar.

Edhe një herë votojmë, votojmë tash!

Unë edhe një herë do ta vë në votim, por në qoftë se nuk votoni, e ka fatin e atyre të tjerëve. Votojmë edhe një herë tekstin e projektligjit, votojmë tash!

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit me 61 vota; 59 për, 2 abstenime.

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara tash. Regjia!

Vetëm pak derisa, faqe 64, regjia nuk ka faj, se jemi duke shkuar vetëm në votimin e projektligjeve, kanë kërkuar shumica e grupeve parlamentare. Votojmë tash!

Janë 58 vota. Nuk ka kuorum. Do ta vë prapë në votim. Në të kundërtën, kjo e ka fatin edhe të këtyre të tjerave. Më duket bukur gjatë në pritje.

2. Votim në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Votojmë tash!

Votim në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale. A dëshironi ta vë edhe një herë apo? Kjo po shihet saktë! Votojeni edhe një herë, bile ndoshta ulet përqindja e votave. Kështu për insistim.

Votoni tash!

A e vëmë edhe një herë? Nuk e ka shumicën e konsiderueshme.

26. Votimi në parim i Projekt-Kodit të Procedurës Penale

Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faqe 45, Votimi në parim i Projekt-Kodit të Procedurës Penale.

Vetëm pak deputetë të nderuar, pastaj regjia në 46 vazhdojmë faqen. Njëherë në 45 jemi, Projekt-Kodin e Procedurës Penale.

Pika 26 regjia. Faqe 45, pika 26.

Faqe 45, pika 26. Falënderoj regjinë. I kërkojmë falje për këtë situatë. Nuk është faji i tyre.

Jemi në votim. Votojmë tash!

Ju kisha lutur regjia, të lutem. Gabim është leximi i dytë. Votimi në parim i Projekt-Kodit të Procedurës Penale. Jo. Po flasim për votimin në parim i Projekt-Kodit të Procedurës Penale, jo shqyrtimin e dytë të Projektligjit për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale.

Unë do t'i kthej këto të cilat nuk e kanë marrë shumicën e cilësuar.

Edhe një herë këta që përfundojnë raundin e parë të votimeve.

Ka ndodhur. Mirë. tash është në rregull. Shumë mirë është. Se jemi në shqyrtimin e parë të Projekt-Kodit të Procedurës Penale.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

70 deputetë, 69 kanë votuar për, një abstenim.

Kuvendin miratoi në parim Projekt-Kodin e Procedurës Penale nr. 06/L-151. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

27. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim

Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar, 63 për, 1 abstenim. Miratohet ky projektligj. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë dhe Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

28. Votimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Votojmë në parim Projektligji për sanksione penale. Votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar, 69 për. Miratohet. Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme ngarkohen që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë dhe Kuvendit t'i paraqesin raporte me rekomandime.

29. Votimi në parim i Projektligjit për Diasporën

Votojmë për miratimin në parim të Proejktligjin e Diasporës. Votojmë tash!

65 deputetë, edhe një me dorë, 66 kanë votuar.

63, përkatësisht, 64 për, 2 abstenime.

Edhe ky projektligj kalon dhe ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë dhe t'i sjellin raporte me rekomandime Kuvendit.

30. Votimi në parim i Projektligjit të punës

Regjia Projektligji i Punës. Votojmë tash!

62 deputetë, të gjithë kanë votuar për. Edhe ky projektligj miratohet në parim dhe i dorëzohet Komisionit Funkcional dhe komisioneve të përhershme ta shqyrtojnë dhe t'i japin në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit rekomandimet.

31. Votimi në parim i Projektligjit për pronën publike

Regjia jemi në radhë. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 61 për. Miratohet edhe ky Projektligj dhe ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë në afatin e paraparë dhe të sjellin raportin me rekomandime.

32. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike

Votojmë!

S'e kemi ministrin. Do ta largojmë.

33. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-247

Votojmë tekstin e Projektligjit në parim. Votojmë tash!

Ky është votimi. Duhet të votojmë edhe një herë në qoftë se dëshironi ju që ta kalojë 61-shin.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Kaloi.

Në fakt, janë disa ligje të cilat s'kanë as për pozitën as opozitën si ky. Mirë që kaloi.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-247.

Ngarkohen Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë në afatin e paraparë dhe t'i sjellin raportet me rekomandime.

Janë dy votime të cilat unë do t'i largoj menjëherë, për faktin se duhen dy të tretat e komuniteteve: Votimi në lexim të dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë.

Sa për protokoll.

Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88. Edhe kjo duhen 11 të komuniteteve, e largoj.

Regjia, koncentrohu në faqe 59 jam.

Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064.... Edhe ky po ashtu e ka fatin e njëjtë. Po ashtu edhe për arsimin e lartë qenka njëjtë, 62.

Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, mbajtur më 28 shkurt 2019

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete

Janë propozuar gjithsej 4 amendamente. Në seancën plenare të 15 prillit, deputeti Mërgim Lushtaku e ka proceduar te Kryetari i Kuvendit edhe riformulimin e amendamentit 1.

Shkojmë te amendamenti 1, i përkrahur nga Komisioni Funkcional, me shtesën i riformuluar nga Mërgim Lushtaku.

Shkojmë në votim. Votojmë tash! 56 deputetë.

Edhe një herë do ta procedojmë, për faktin se në qoftë se s'kalon një amendament, ne kot vazhdojmë më tutje. S'mund as të procedojmë.

Edhe një herë amendamenti në fjalë. Votojmë tash!

Edhe ky rezultat është i njëjtë. A ka ndonjë zgjedhje apo ta largoj? As nuk ka tërheqje nga amendamenti as nuk ka votim. Po. Asnjë pikë nuk do të anashkalohej. Jemi vetëm në projektligje, asnjë nuk do të anashkalohej. Për cilin? Jo, jo e kemi vendosur, po nuk po votohet. Jo, jo, të gjitha, asnjë s'i largohet. Jo, jo, mos u mërzhit. Vetëm. Është, do të jenë të gjitha, mos u mërzhitni, veç ju kisha lutur vëmendje. Asnjë pikë e rendit të ditës, se jam bukur shumë, janë diku mbi afër 90 pika të rendit të ditës. 24? Të gjitha do të vendosen, të jeni të sigurt. Edhe unë kisha pasur dëshirë vëmendje.

Unë po e largoj për faktin se përderisa nuk votohet s'kam pse të procedoj më tutje.

Vetëm koncentrim ju kisha lutur deputetë! Regjia ma sill!

Tash po dal edhe një herë. Tash vetëm të jemi korrekt. Tash çka është kijeni parasysh, këto të cilat i keni pika të rendit të ditës, asnjë nuk do të kalojnë në seancë pa ju sjellë në seancë. Ta keni parasysh.

Më lejo edhe një herë. A kemi të bëjmë me shqyrtimin e dytë? Koncentrim! Të cilin e vendosa në votime, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale? Vetëm a ka mundësi një minutë të lutem? Një minutë a ka mundësi?

Ju kisha lutur koleg deputetë i Lëvizjes Vetëvendosje, ju lutem vetëm pak, po më maltretoni. Jo, jo, prit zonja deputete! Vetëm ta sqaroj unë. Po më maltretoni në mënyrë jokorrekte për faktin se tri herë e vendosa në votim. Nuk ia jep votën. Unë e pyeta, e kisha lutur regjinë. Të lutem Glauk, të lutem për korrektësi. Tri herë e kam vendosur në votim për shkak të pak a shumë edhe të atmosferës së tensionuar, edhe pak a shumë inateve, po kalohet.

Ju kisha lutur juve koncentrim. Unë e vë prapë në votim. Jo, jo tash. Urdhëro zonja deputete! Regjia deputetes. Zonjës Nagavci, regjia!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Vetëm sa për sqarim. Në tabelë ishte e shënuar pika 24, gjegjësisht shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, ndërsa ju deklaruat diçka tjetër dhe kërkuar nga regjia që të tërhiqet e njëjta. Pra, diçka tjetër ishte paraqitur dhe diçka tjetër e deklaruar më herët.

Kështu që të lutem e vendosni edhe një herë në votim.

KRYETARI: Jo, jo. Vetëm pak. A ka mundësi koncentrim, deputetë! Rrini në sallë! Ju kisha lutur vetëm për hir të publikut, nuk dua, më fal zoti Konjufca po ju drejtohem ju se je kryetar i Grupit Parlamentar. Nuk dua të tregohem. Memli Krasniqi në qoftë se ka mundësi, ose bëni debat personal ose? Unë ju kisha lutur për hir të publikut. Unë po mundohem. Memli Krasniqi, fjala për ju.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Po besoj e po dua të shpresoj që është keqkuptim, po përndryshe mund të jetë mungesë e koncentrimit dhe e fokusimit. Dy herë e kemi votuar këtë propozimin e Vetëvendosjes që është leximi i dytë i Projekt-kodit që e ka vetëm si të them një çështje që e trajton dhe pastaj e kemi votuar Projekt-kodin në lexim të parë që e ka sjellë Qeveria.

Nuk ka hapësirë këtu për konfuzion për ata që merren me këtë punë. Dy herë nuk ka marrë votat e mjaftueshme shqyrtimi në lexim të dytë i propozimit të Vetëvendosjes, ndërsa Projekt-kodi i dorëzuar prej Qeverisë i ka marrë votat e mjaftueshme dhe nga shqyrtimi në lexim të parë tash kalon në lexim të dytë.

Sikur qysh e kemi bërë praktikë, ne mund t'i rikthehemi edhe një herë. D.t.th. dy herë mund të votojmë, po mos të manipulojmë të themi ka bërë gabim. Nuk është bërë gabim. Gabimi u bë i regjisë dhe atë përmirësim e bëri Kryetari kur ju tha s'është kjo se kjo u krye dy herë, s'kaloi. E kemi tash shqyrtimin e Projekt-kodit të parë. Fokusohuni të nderuar kolegë, sepse është me rëndësi të paktën kur të flasim, të dimë për çka po flasim.

Zoti kryetar, nëse i kthen në votim edhe një herë ato që s'kanë kaluar për një votë, dy votë, pesë votë, të lutem që ta bëjmë sipas radhitjes që e bëmë më herët. Pra, tash nëse kanë mbetur në lexim të dytë të provohen edhe nga një herë, e para duhet të vijë Projektligji për tatim në të ardhura personale, pastaj ai për korporata, pastaj çka ka mbetur, pastaj edhe ky projekt-kodi në lexim të dytë. Nëse kalojnë, kalojnë, nëse s'kalojnë, s'kalojnë. Barten qysh i kemi bartur deri tash. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë për hir edhe të publikut. Fatmirësisht kemi edhe procesverbal i cili është i shkruar këtu. Për besë njeriu shumë lodhet, edhe nganjëherë po e shoh se sado korrekt, shumë në mënyrë abuzuese është sjellja. Ka qenë, dy milionë qytetarë e kanë parë, është vënë në votim, por për shkak ndoshta të idhnimeve shumë, edhe paragjykimeve, fare nga inati po u humb edhe koncentrimi.

Unë ftoj regjinë, le ta sjell nga procesverbali në qoftë se ju duhet, pastaj unë do të procedoj në bazë të këtij rendi çka e kam. Edhe njëjtë. Kijeni parasysh, njëjtë do t'i vendosim në votim. Janë disa pika të cilat nuk kanë kaluar deri tani. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale nuk ka kaluar. Në të ardhurat e korporatave nuk ka kaluar për shkak të një amendamenti. Kodi i Procedurës Penale, leximi i dytë nuk ka kaluar. Kemi vendosur.

Po do t'i vendos të gjitha, vetëm ta kemi parasysh. More, kjo është bërë zor njeriu edhe të njohë vetveten tash. Po jo bre Sami! Sami, po mos, se s'kuqesh, se e kam vendosur në votim. Sami ulu!

Media të nderuara, ne në mes vete s'po mund të merremi vesh. Ju kisha lutur juve, i merrni materialet te regjia e shikojeni a është manipulim, apo është abuzim? Abuzim i Vetëvendosjes apo manipulim i Kuvendit? A ka mundësi për pesë minuta vjen raporti. Për pesë minuta. Mirë tash, a është korrekte? Vjen raporti, dikush kërkon falje. Është mirë të kërkohet falje, ose unë, ose ata.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike

Janë 42 amendamente, të cilat janë shumica, t'i vërtetojmë, janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. 42 amendamente. Vetëm e presim regjinë, pesë minuta.

Jemi te pika Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike. Janë 42 amendamente. A kisha pasur mundësi?

Regjia, deputetët, përgatitemi për votim.

Jo mos ma thuaj mua. Thuaja deputetëve, se mua s'ke nevojë të ma thuash.

Regjia po thotë mirë është, në kuptimin se ne jemi korrekte në procedim, por ua thoni deputetëve dhe mediave.

Seanca vazhdon. Ju kisha lutur!

Ka pasur, votimi ka dalë, nga ju keni votuar, i ka marrë 52 vota, tri amendamentet.

Po do ta vendos edhe një herë. Për këtë arsye, do t'i vendosi të gjitha edhe një herë. Po e thash.

Zonja Pacolli jeni shumë e fuqishme, edhe e zonja, po të jesh edhe më e fuqishme, s'e kam ndërmend të të dëgjoj me respektin për ty. Glauk. Tani po thonë, me insistim.

A vazhdojmë, pastaj i vendosi ashtu siç ka qenë radhitja? Po s'ka qare pa dalë se unë e kam thënë prej fillimit. Unë mendova Glauk, unë e kuptova shqetësimin e juaj, mendova se është manipulim i cili ka ndodhur, edhe unë u konfuzova. Më vonë e morëm vesh që ka dalë në votim.

Vetëm pak, se jemi drejt qartësimin edhe publik, ka edhe një konfuzion, i cili ka dalë pastaj më vonë kur ishte Projekt-kodi. Nuk mund të vihet pika e Kodit të Procedurës Penale, pasi s'kaluan amendamentet. Për deputetët e Vetëvendosjes, më herët në fillim, ka qenë në votim dhe i kanë marrë 52 vota të tria amendamentet dhe nuk kaluan.

Kë ta hedh në votim? Zonja Pacolli merre fjalën dhe ma thuaj se kë ta qes në votim?

SAMI KURTSHI: Ma jep fjalën të lutem?

KRYETARI: Zoti Kurteshi e keni fjalën.

SAMI KURTESHI: Problemi është i natyrës politike, nuk është i natyrës teknike. Është plotësim-ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale që parasheh gjykimin në mungesë.

Kjo është propozuar nga Lëvizje Vetëvendosjes për dënimin e krimeve të luftës. Edhe është votimi në parim i Kodit të Procedurës Penale që e ka propozuar Qeveria, i cili nuk parash gjykim në mungesë. Ky është dallimi.

Këtu është bërë loja politike. Nuk ka asgjë tjetër.

KYRETARI: Armend Zemaj. A ka mundësi që ta kem vëmendjen tuaj. Sami, faleminderit! Armend, je opozitë dhe kisha pasur dëshirë...Në qoftë se kemi qenë të koncentruar, a e kemi vendosur shqyrtimin i dytë i Projektligjit për plotësim ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, tre amendamentet dhe nuk kanë kaluar.

Po, a i kemi vendosur?

ARMEND ZEMAJ: Një amendament.

KRYETARI: Një amendament. Jo, të tria bashkë i kam vendosur për regji. Nuk kanë kaluar. A ka qenë kjo?

ARMEND ZEMAJ: Amendamenti i parë.

KRYETARI: S'ka kaluar?

ARMEN ZEMAJ: Po, njëshi.

KRYETARI: Kur nuk kalojnë amendamentet, a mund të vendoset projektligji në tërësi për votim?

ARMEND ZEMAJ: Nuk e di a e keni theksuar ju atë. Për procedent kemi kërkuar që nuk kalon...

KRYETARI: Po, kjo është. Pikërisht kjo. Për hir të zotëri Kurteshit, nuk kanë kaluar amendamentet. Më vonë për korrektësi, duke e kërkuar projekt-kodin e Procedurës Penale, ka dalë po ashtu edhe njëherë kjo pikë e rendit të ditës. Ta keni parsysh.

Pra, i kam kërkuar regjisë që ta largojë për faktin se në momentin kur nuk kalojnë amendamentet, s'mund ta kalosh projektligjin në votim. Nuk mund të kalojë. Është joligjore dhe kundër Rregullores. Këtë desha ta them. Për atë po e them.

Zoti Zemaj, të gjitha ligjet, projektligjet të cilat nuk kanë kaluar edhe njëherë do të vendosen në votim, por ju kisha lutur që kur të votoni ta keni vëmendjen dhe koncentrimin në sallë.

Të mos na nxirrni probleme neve, përkatësisht mua, që unë ta vendos në votim, e ju nuk votoni. Kjo është ajo që duhet ta them. S'ka manipulim politik. Nuk ka veprim as të nxitur dhe as të fshehur, ka transparencë.

Mediat i kisha lutur që ta analizojnë dhe ta bëjnë pasqyrimin ashtu siç duhet.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike

Janë gjithsej 42 amendamente. Të gjitha janë me përkrahjen Komisionit Funkcional. Votojmë 42 amendamentet për qasje në dokumente publike. Kemi të bëjmë me...

Kërkoj falje, kam edhe një udhëzim nga administrata.

Leximi i dytë i draft-ligjit për qasje në dokumentet publike humben, kisha pasur dëshirë për vëmendje, humben 900 mijë euro nëse nuk aprovohet sot. Kjo është. Nuk e di, është interpretim i administratës. Humben 900 mijë euro. Nuk është interpretim imi me qëllim që t'ju detyroj të votoni. Është çështje e juaja. Nuk është interpretim imi, vetëm se e mora tani nga administrata që ta keni parasysh.

Votoni si të doni, është bindje e juaja. 42 amendamente, votojmë tash. Bekim, a dëshiron që t'i humbasim 900 mijë euro? Qëndro, këtu. Edhe Bekim Haxhiu është me dorë. Sa veta janë me dorë?

Ta keni parasysh, është një interpretim i cili nuk ishte imi dhe ndërlidhet me ato para. Se a qëndron apo nuk qëndron s'mund ta them unë.

Jemi duke votuar 42 amendamentet edhe njëherë, votojmë tash. Janë 60 deputetë, votojmë edhe njëherë. Kërkohe koncentrim ju lutem. Votojmë edhe njëherë për 42 amendamentet.

Bash po më pëlqen kjo sjellje sot, madje prej se jam kryetar Kuvendi. Për arsye se...

Edhe njëherë votojmë. Votoni apo nuk votoni është qëndrim i deputetëve. Votojmë tash. Si të doni votoni për 42 amendamentet.

60 vota. Do të thotë, edhe ky e ka fatin...

Jo, nuk ka nevojë. Në qoftë se e deklaron ai votën, në regji nuk e ka pasur votën, atij i pranohet, ngase s'mundet që askush t'ia mohojë votën.

Albert, a ke votuar në mënyrë elektronike? E përsërisim edhe njëherë. Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani 42 amendamentet.

Kaluan 42 amendamente. Shkojmë në votimin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Regjia, a jeni gati? Ndërkohë të nderuar deputetë, kam kërkuar nga administrata që t'ju shpërndahet votimi për projektligjin e kontestuar nga ana e deputetëve. Pra, do tua sjellim me emra e mbiemra.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike. Jemi duke i votuar amendamente në tërësi me projektligjin. Votojmë tash. Ju lutem, votojmë tash. Po piqet demokracia në Kosovë.

Një kolegë yni, thoshte sharmi i demokracisë. Po e dini për kë e kam fjalën.

Edhe njëherë, dëgjoni. E gjithë kjo është në rregull dhe nuk ka asgjë negative. Shkojmë në procedura. Vetëm për diçka ju siguroj. Për sa kohë që do të jem kryetar i Kuvendit, të gjitha do të shkojnë në votim. Asnjë s'largohet. Secila votë e secilit del në votim. Kjo është.

Mendimin s'mund tua ndërrojë askush. Mund të ketë ndopak polarizim. 59 vota i ka marrë...Në rregull, edhe njëherë e qes, po ngadalë mos u ngutni, ngase me zor nuk mund t'i shtini deputetët që të votojnë. Kur duan, duan, kur s'duan nuk duan.

Votojmë edhe njëherë në tërësi me amendamentet e miratuara.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike.

Kërkoj falje! Faleminderit shumë për përqendrimin. Tani do shkojmë në votimet të cilat janë të raporteve të komisioneve. Ndryshe, nëse dëshironi, meqë ka insistim, po krijohet keqkuptim, i kthehem edhe njëherë këtyre që s'kanë kaluar...

A kthehemi edhe një herë? Në rregull, kthehemi edhe një herë, vetëm se duhet përqendrim. Të gjitha këto që do t'i vendosi tani, kanë qenë të vendosura edhe njëherë. Pra, është votuar edhe njëherë për to, por nuk i kanë marrë 61 vota.

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Ka mbetur amendamenti i zonjës, Shqipe Pantina edhe i Bekim Haxhiut. Regjia, duhet të na tregojë...Zonja Pantina a i ka kaluar 61 vota? Nuk kaloi. Do të thotë s'ka kaluar.

Jemi te amendamenti i 16. Propozim i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, i cili kishte të bënte me sponsorizime.

As i juaji s'ka pasur të mjaftueshme. Jo, atëherë duhet të kalojmë edhe tek amendamenti i juaji 7. Zonja Pantina edhe njëherë, flisni për amendamentin dhe unë e vendosi në votim pastaj e shohim nëse kalon apo jo. Ju vendosi për këtë.

Regjia ju lutem, zonjës Pantina fjalën.

SHQIPE PANTINA: Atëherë, për shkak se ka kaluar një kohë e gjatë, dhe për fat të keq as unë nuk e kam të shkruar saktësisht amendamentin para vetës, por kërkesa bazë është që ushqyesit e familjes, do të thotë vetushqyesit të lirohen nga tatimi në të ardhura personale.

Por, detajet duhet të hartohen me një udhëzim administrativ nga Ministria e Financave, e cila është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji. Faleminderit!

Natyrisht se i ftoj të gjithë deputetët që të votojnë pro këtij amendamenti.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votimin e amendamentit për kaq. Votojmë tash në mënyrë elektronike.

Për korrektësi, deputetët e dinë po për hir edhe të publikut. Në momentin kur nuk kalon një amendament ne s'mund të vazhdojmë tutje. Kot vazhdojmë. Ky është problemi.

Totalisht, kjo është situata dhe të mos krijojmë pastaj keqkuptime të panevojshme në publik. Edhe kjo mbetet prapë. Është e dyta herë që e vendosa sot.

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Ka mbetur një amendament. Më duket se të gjitha amendamentet kaluan. Ishte amendamenti i pestë, Bekim Haxhiu ju lutem, pa përkrahjen e Komision FunkSIONAL.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Për shkak se një numër i deputetëve tani ka ardhur në sallë edhe në fillim nuk ishin për ta parë dhe arsyetuar këtë amendament. Po e përsërisë shkurt.

Ka amendament mundëson zbatimin e Ligjit për sponsorizime në Republikën e Kosovës për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Ligji është miratuar më 19 janar 2017, ka hyrë në fuqi në fakt, por nuk ka arritur që të implementohet për shkak të mosharmonizimit me Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Sot, me këtë votim mundësohet që në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të investohet edhe nëpërmjet sponsorizimit.

Prandaj, kërkoj votën e të gjithë deputetëve me qëllim të miratimit dhe të harmonizimit të këtyre dy projektligjeve dhe që sporti në Kosovë të zhvillohet. Ashtu siç kemi kërkuar dhe e mbështesim sportin të gjithë nga ne, kërkoj që sot këtë ta bëjmë me votën tonë, me qëllim të zhvillimit të sportit në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është amendamenti numër 5 nga Bekim Haxhi pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash.

E pëson të njëjtin fat edhe ky projektligj. Në qoftë se deputetët nuk tërhiqen, ne duhet ta ndalim këtu votimin.

Ju kisha lutur për vëmendje për hir edhe të korrektësisë. Kemi marrë raportin e regjisë. Në orën 12:08 kemi votuar amendamentet pikërisht në këtë Projektligjin për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Pra, kemi votuar në orën 12:08.

Për, kanë votuar 41 deputetë. Kundër, ka votuar 1. Ndërkaq, kanë abstenuar 10 deputetë. Gjithsej kanë votuar 52 deputetë.

Do ta qesim në publik edhe mënyrën e votimit sesi ka shkuar. Do të thotë kjo është arsyeja. Pra, votimi i orës 12:08. Do ta doja vëmendjen tuaj për hir të publikut. Në orën 12:20 ka dalë shqyrtimi i parë i projekt-kodit që ndërlidhet pikërisht me atë gabimin e regjisë, ngase e ka rikthyer prapë drejt projektligjin. Pra, atëherë kthehet.

Pastaj kemi votuar për projekt-kodin e Procedurës Penale, i cili i ka marrë 69 vota për dhe 1 abstenim. Do të thotë kjo ishte.

Qesh Armend qesh, kollaj për ty.

Në orën 12:08, ta keni parasysh. Nuk jam për të bërë gara për ta përfunduar këtë pjesë, por vetëm për hir të publikut.

Tani e vendosim në votim. Bilall, ju lutem sa më shkurt. Urdhëro, zoti Bilall. Vetëm se duhet të shkojmë në votim.

BILALL SHERIFI: Kryetar, unë po marr fjalën në cilësinë e anëtarit të komisionit. Nuk do ta kisha marr, sikur të mos kishte folur për këtë çështje Sami Kurteshi.

Dëgjoni. Kur kemi diskutuar për këto të tria amendamentet e Vetëvendosjes në komision, situata ka qenë me sa vijon; ata kanë thënë, kanë kërkuar që të procedohen këto tri amendamente me arsyetimin se Qeveria nuk e ka ndërmend ta sjellë këtë ligj.

Ne, të gjithë në komision e kemi mbështetur këtë iniciativë. Por, ka qenë një marrëveshje se nëse e sjellë vërtetë Qeveria këtë ligj, atëherë këto të tria amendamente do të përfshihen në procesin e Projektligjit të ardhur nga Qeveria.

Pra, e kemi votuar në lexim të parë në komision. E kemi votuar në lexim të parë në Kuvend, me idenë edhe me shqetësimin se Qeveria nuk do ta sjellë. Ky ka qenë augmenti. Tash ka ardhur.

Ne e dimë që projektligji i ardhur nga Qeveria nuk është mjaftueshëm i qartë në këtë çështje, por mendoj që në procesin nga leximi i parë në leximin e dytë, këto të tria amendamente mund të

përshtatën dhe të përfshihen në ligjin që sapo e kaluam në lexim të parë. Pra, nuk ka të bëjë me lojëra.

E di mirë Albulena e cila është kryetare, se sa fuqishëm e kam mbështetur idenë që në ligj të parashihen mbajtjet e proceseve, zhvillimin e proceseve, ngritjen e aktakuzave dhe zhvillimin e procese në mungesë.

Nëse vërtetë duan, atëherë unë do tua votoj edhe sot, ngase u kam thënë në komision. U kam thënë edhe e kemi votuar edhe në lexim të parë dhe do ta votoj. Pro, do të ishte mirë që të ulemi këtu dhe së bashku ta çojmë deri në fund marrëveshjen, në mënyrë që kur të vjen nga Qeveria t'i përfshijmë këto të tri amendamente.

Në parim e kemi votuar. Në komision e kemi votuar dhe sërish do ta mbështesim sot. Por, gjithsesi se kjo çështje duhet të përfshihet edhe në projektligjin e ardhur nga Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Në rënd të parë, nuk është mirë që të kemi ngarkesë. Zoti Sherifi i qartësoi shumicën e çështjeve, por nuk ka pasur koncentrim, ngase po e shoh që asnjëri nga kolegët e Vetëvendosjes, kur janë votuar ato amendamente të cilat paskan qenë aq të politizuara, s'kanë votuar.

Do të thotë se koncentrimin... Është edhe në televizion, janë të protokolluara. Tashti situata është reale, pra kjo e cila është. Nuk është mirë të kthehemi në të kaluarën. Vendosi, dhe votoni tani në qoftë se e keni ndërmend.

Ministri e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Veç dua ta bëj një sqarim. I përkrah amendament që i keni propozuar pa dyshim, por vetëm ta them një çështje, nenin 306 i projekt-kodit të Procedurës Penale të cilën e ka proceduar Qeveria e Republikës së Kosovës e përcakton qartë gjykimin në mungesë. E përcakton shumë qartë.

Pra, e përcakton qartë se kur gjyqtari i procedurës paraprake ose trupi gjykues mund të vendos për vazhdimin e gjykimit në mungesë në rast se i akuzuari nuk paraqitet. Është shumë e qartë.

E kemi edhe një dallim këtu te gjykimi në mungesë. Propozimi i juaj është vetëm për krime lufte, ndërkaq propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është për të gjitha veprat penale. Pra, mund të gjykohet në mungesë edhe një person i cili është i dyshuar për krim të organizuar e edhe për korrupsion.

Me propozimin që e ka sjellë Qeveria e Republikës së Kosovës përfshihen të gjitha këto vepra.

Me propozimin tuaj, janë vetëm krimet e luftës.

Pra, ne i përkrahim padyshim. Kjo i bie që ne e kemi më të gjerë këtë gjykimin në mungesë duke përfshirë pa dyshim edhe njerëzit të cilët kanë kryer krime lufte, mirëpo edhe ata që janë të përfshirë në afera korruptive, në krim të organizuar e që nuk paraqiten para gjykatës.

Andaj, këtu është dallimi mes propozimit tonë dhe atij tuajit. I mbështes, pa dyshim. Mirëpo, nuk mund të limitohemi gjykimi në mungesë vetëm për krimet e luftës. Kjo duhet të jetë edhe për veprat tjera penale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Regjia, do të doja që deputetët të kthehen në sallë. Të kthehen në sallë deputetët të cilët janë në bife, dhe kjo të ndodh para votimit.

Ishin këtu shumica e deputetëve, mirëpo le të kthehen tani meqë një pjesë është larguar. Regjia, bjeri ziles në mënyrë që të votojmë ngase i kemi edhe tri projektligje të cilat duhet të votohen edhe njëherë. Deri sa t'i marrin 61 vota këto do të vijjnë çdoherë.

Fat i mirë është edhe i përgëzoj deputetët se janë kryer një sasi shumë e madhe e projektligjeve të cilat kanë qenë në pritje. Kanë mbetur në fakt edhe tre apo katër. Pra, këto po ripërsëriten që disa herë.

Regjia, sa deputetë i kemi në sallë? Atëherë, shkojmë në votim.

24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Jemi tek votimi i tri amendamenteve të propozuar të cilat duhet të votohen. Unë do t'i votoj të tria në të njëjtën kohë, për faktin se të tria janë nga Komisioni Funkcional.

Regjia dhe deputetët le të përgatiten për votim. Votojmë tani tri amendamentet e propozuara.

Përcillni ekranin, ju lutem! Amendamentet sipas radhës së paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional. Kanë votuar 72 deputetë. 68 për. 4 deputetë kanë abstenuar. Kalojnë tri amendamentet.

Votimi i amendamenteve të propozuara në Komisionin Funkcional.

Urdhëro, lexo për publik, të lutem!

GLAUK KONJUFCA: Çka thotë kjo, amendamentet nga komisioni, nga cili Komision Funkcional, nga cili ligj, nga cili projekt-kod, jo atje në tabelë duhet nxjerrë për ta shkruar.

KRYETARI: Po më vjen keq për këtë situatë, të cilin e keni krijuar. Nuk është puna e regjisë, është gabim në koncentrimin tonë. Glauk, jemi para televizionit, të gjithë e kanë lexuar, e kanë dëgjuar, e kanë shikuar atë çfarë keni votuar, do t'u dalë sonte.

Po e votojmë projektligjin, se kjo është më me rëndësi, po zoti Nitaj. Urdhëro, shkojmë te projektligji, zoti Nitaj, shpejt.

MUHARREM NITAJ: Zoti kryetar!

Kam bërë një gabim, kam votuar në emër të koleges Emilija Rexhepi, kështu që ju lus që ta përsëritni votimin edhe një herë, se nuk dua të dal që kam votuar në emër të një deputeti tjetër.

KRYETARI: Ju kisha lutur, mos e ngarkoni, shkojmë edhe një herë, jo se s'mund, Bilall, ti e di, nuk mund të ndërhyjë askush në proces të votimit të votojë diçka, në Rregullore është.

Shkojmë edhe një herë amendamentet për shkak të gabimit, ju kisha lutur, se ligji është më me rëndësi se sa çdo gjë, ky ligj.

Kemi tri amendamente, për procesverbal, fshihet ajo të cilën e kam konstatuar, për shkak se një nga deputetët ka konstatuar gabimin, të mos i japim asnjë pretekst të kalojë në Gjykatën Kushtetuese.

Votojmë edhe një herë, të njëjtit deputetë jemi. Ju lutem për mirëkuptim, tri amendamentet i votojmë përnjëherë. Faleminderit! Votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar, 65 për, 3 kundër dhe 2 abstenime.

Kaluan tri amendamentet.

Jemi në votimin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Votojmë tash, me amendamentet e miratuara:

Glauk, kisha pasur dëshirë, duke ta uruar ligjin, shiko çfarë po del, ky është momenti pasi i kemi kaluar amendamentet, atje i nxjerr të raportit të Komisionit, pastaj është projektligji dhe votohet, ky është ai dallimi, i cili e krijoi konfuzionin te ju.

Tash kalojmë drejt në projektligj: me 70 vota, 65 për, 3 kundër dhe 2 abstenime, ka kaluar Ligji nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës numër 04/L-123.

Urime, faleminderit!

I kemi vetëm edhe dy, të cilat kanë qenë në votim njëjtë, e marrin apo jo përkrahjen tuaj, kjo varet nga ju, është:

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara në këtë projektligj. Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash!

Vetëm pak, regjia s'ka faj.

Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale, faqe 64 regjia, seanca e 12 shkurtit 2019. Jemi tani në votim, votojmë tash:

57 deputetë, mbetet çështje e hapur.

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin nr. 05/L-132 për automjete

Kemi mbetur te amendamenti 1, i cili është i përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL, i riformuluar nga deputeti Mërgim Lushtaku, foli deputeti. Votojmë tash!

57 deputetë.

Rregullorja e parasheh qartë, kur nuk votohet amendamenti, s'mund të procedojmë tutje.

3. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti, votojmë tash!

Faqe 13, regjia, është votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, po kjo është, votojmë tash:

Janë 58 deputetë, mbetet çështje e hapur.

4. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare

Votojmë tash!

Edhe ky raport e ka të njëjtin fat, për arsye se s'e kanë votuar 61 deputetë.

5. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Votojmë tash!

Edhe ky e ka të njëjtin fat.

Po, po ju dëgjoj për pauzë, unë e kam këtë shqetësim, vetëm pak.

Një pjesë e deputetëve, të cilët janë jashtëzakonisht të rregullt, vijnë edhe pas pauzës edhe qëndrojnë, tani jemi vetëm në votim, frikësohem se pasi të jap pauzën deputetët nuk vijnë në votim, vijnë vetëm ata të cilët janë të rregullt.

Unë kisha thënë më mirë të votojmë tash, çka dëshironi të votojmë e të mos i maltretoj deputetët t'i sjell pas dy ore prapë edhe një herë. Ky është mendimi im, po ju e vendosni, unë ju thërras, ju pres në orën që e lëmë.

A të vazhdojmë edhe pak, derisa janë mbi 60 deputetë.

6. Votimi i raportit të suditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017

Votojmë tash! Faleminderit!

Unë do të kaloj një për një për pikat. Zoti Ymeri, urdhëro fjalën!

VISAR YMERI: Kryetar, faleminderit edhe një herë!

Po dua ta përsëris atë kërkesë, të cilën si mocion e votuam në fillim, do të ishte mirë, meqë kemi deputetë në sallë dhe nuk ka kundërshtime për buxhetin e Komisionit Hetimor, kisha propozuar që ta fusim tash në votim, në mënyrë që ta përfundojmë këtu e të mos mbetet çështje e neglizhencës. Nëse ka kundërshtime, është tjetër gjë, po nëse nuk ka kundërshtime, të mos na mbetet për ndonjë seancë tjetër se vërtet po ia vështirëson shumë punë Komisionit Hetimor.

KRYETARI: Vetëm pak. Ndërkohë, regjia e paska sjellë shumë mirë që e vure në vëmendje, është:

- Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me gjendjen në Postën e Telekomit e Kosovës dhe Vala për miratimin e buxhetit të këtij komisioni

A shkojmë në votim drejtpërdrejt. Urdhëro, zonja Vjosa!

VJOSA OSMANI: Këto kërkesat për buxhet të komisioneve hetimore parlamentare nuk është fare e udhës dhe është edhe në kundërshtim me Ligjin për hetim parlamentar që të votohen në seancë. Ato fare nuk ka nevojë të votohen në seancë, sepse me Ligj për hetim parlamentar atyre u takon buxhet, edhe komisionet ad hoc parlamentare duhet trajtuar si çdo komision tjetër edhe sa i përket buxhetit.

Në qoftë se, për shembull, një kryetar komisioni në fillim të punës së komisionit e ka dërguar kërkesën edhe për buxhet, siç ka ndodhur për disa komisione paraprake hetimore, atëherë ato duhet të miratohen në Kryesi, e jo këtu të nxirren deputetët në pozitë të pavolitshme që ata në seancë plenare të kërkojnë ndarjen e buxhetit, i cili shfrytëzohet për procedura administrative, kryesisht. Kështu që këto gjëra thjesht duhet ju si Kryesi t'i miratoni, këto kërkesa, e jo t'i sillni në seancë, po pra duhet sekretaria, administrata t'i realizojnë, sepse në Ligj për hetim parlamentar parashihet që i takon buxheti. Nuk ka nevojë për buxhet të vendosë seanca, sepse në ligj nuk shkruan.

KRYETARI: Faleminderit! Në aspektin logjik ndoshta kjo qëndron, çka tha deputetja, po kështu e kemi rregulluar, ndërroni Rregulloren, e vetë fakti se Kuvendi përcakto këto, jemi të detyruar t'i sjellim në seancë, s'kemi çka t'i bëjmë. Po më mirë të votojmë edhe këtë herë, e të mos merret si bllokim i punës së komisionit, ta votojmë.

Keni të drejtë, ndoshta do të ishte mirë, kjo në mënyrë logjike, po procedurat janë të tilla.

Atëherë, a e votojmë vetëm me dorë. Janë 71 deputetë. A ka dikush kundër t'ua aprovojmë buxhetin? Abstenim. Aprovohet nga të gjithë.

Aprovohet kërkesa e Komisionit Hetimor.

7. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti, votojmë raportin. Votojmë tash!

As mjedisin, nuk po e aprovojnë asnjë raport.

60 deputetë.

8. Votimi për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

I keni emrat, të mos i përsëris, shtatë anëtarë. E kemi vënë në votim edhe disa herë, nuk ka marrë votën e 61 deputetëve, i votojmë edhe këtë herë këta shtatë anëtarë tash:

Edhe këta nuk e kanë fatin ta marrin besimin tonë.

9. Votimi për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare

Edhe kjo pikë e rendit të ditës ka qenë disa herë, votojmë tash:

As ky se ka marrë përkrahjen.

10. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës

Votojmë tash!

Edhe kjo ka të njëjtin fat.

11. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Votojmë tash!

12. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave

Votojmë tash!

Çdo votim që s'i ka 61 deputetë, mbetet i heshtur, pa vendimmarrje. Ripërsëritet.

Edhe kye ka të njëjtin fat.

19. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësive institucionale të Qeverisë së Kosovës

Votojmë tash! Faleminderit!

34. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me mosçaktivimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës

Votojmë tash!

Edhe ky e ka të njëjtin fat.

35. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP të Partisë Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a. NKEC

Votojmë tash! Faleminderit!

Unë do të shkoj një për një për t'i votuar këto, të cilat i kemi në rendin e ditës sot, e vendimmarrja është juaja.

1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore

Duhen 2/3 e deputetëve edhe të komuniteteve.

Në qoftë se ka insistim unë e vendos, prit, të shkoj deri në fund këto, e mbaj pagën minimale, e kthej menjëherë. Të shkoj me rend, ju lutem, cilën dëshironi, unë e vendos edhe një herë, po shkoj me rend.

Votimin e fshehtë po e mbaj për më vonë. Kërkoj falje vetëm për hir të mbarëvajtjes së seancës, edhe për shkak tuajin, ju kisha lutur. Bilall, urdhëro fjalën derisa t'i përgatis me administratën këto pikat, të cilat kanë mbetur.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Me sa e di, kur është debatuar për pagën minimale, me përjashtim të një deputeti, të gjithë unanimisht kanë qenë që të miratohet një rezolutë që autorizon Qeverinë për të ngritur pagën minimale. Nuk kemi folur këtu për shumë, por që Qeveria të punojë së bashku me Këshillin Ekonomik-Fiskal, Ministrinë e Punës e kështu me radhë me të gjithë aktorët që të punojë në këtë drejtim.

Nëse kjo rezolutë sot nuk kalon, atëherë ka hipokrizi dhe ne nuk marrim pjesë në asnjë votim tjetër. Përderisa kjo rezolutë nuk merr votat të mazhorancës, sepse edhe PSD-ja ka qenë ngritëse e mocionit dhe të kalojë, nuk marrim pjesë në asnjë votim tjetër. Ose nxirreni menjëherë në votim, ose ato të tjerat, siç po propozoni që t'i nxjerrin një herë ato, pastaj të fillojmë edhe një herë këto çka kanë mbetur t'i nxjerrim në votim, atëherë deklarojmë se të gjitha këto pastaj do të duhej të presin në radhë, këto pikat e tjera derisa të kalojë rezoluta. Pra, nëse ne duhet të presim, të jeni të sigurt se edhe këto pikat e tjera do të presin.

KRYETARI: A shkojmë edhe një herë, vetëm pak, të mos e komplikojmë. Unë po rikthehem, a dëshironi edhe një herë, çka doni të ktheni? Zoti Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Për sa i përket rezolutës si rezultat i debatit për rritjen e pagës minimale, ne e kemi pasur një takim me grupet parlamentare, me ato grupe që kanë qenë të interesuara dhe kemi bërë një harmonizim të tekstit bashkë edhe me grupet e tjera parlamentare, edhe nga seanca atëherë, me sa më kujtohet, nuk ka pasur askush asnjë vërejtje kundër kësaj dhe nuk po e kuptoj pse tash jemi në një situatë ku nuk po votohet një rezolutë, e cila nuk bën asgjë tjetër, përveçse kërkon një përqendrim të shtuar dhe rritje e përshpejtim të procesit të dakordimit në kuadër të Këshillit Ekonomiko-Social të pagës minimale dhe pastaj të vendimmarrjes institucionale nga Qeveri për ta zbatuar këtë pagë minimale. Pra, kanë kaluar më shumë se 8 vjet që kur paga minimale asnjëherë nuk është prekur, ka pasur zhvillime të jashtëzakonshme, dramatike e ekonomike, sikur në rritjen e çmimit të jetesës, sikur në rritjen e pagave në sektorin publik dhe sektori privat ka mbetur i paprekur.

Mendoj që është përgjegjësi i këtij Kuvendi dhe jemi në moment shumë të vonuar, në mënyrë që të kërkojmë edhe një herë përsheptim nga institucionet të procedurave që të adresohet kjo çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për të gjithë të punësuarit në Republikën e Kosovës. Prandaj, kërkoj edhe një herë që të vihet kjo rezolutë e harmonizuar, po e përsëris, në votim dhe t'i marrë votat e Kuvendit, në mënyrë që pastaj procedura të ecë para. Përndryshe, nëse nuk vihet në votim edhe një herë, edhe ne si Grup i Partisë Socialdemokrate nuk do të marrim pjesë në asnjë votim tjetër për sa kohë që kjo rezolutë nuk e merr një epilog të votave në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Krasniqi, edhe pastaj zoti Zemaj.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Megjithatë, krahasuar me disa seanca të tjera, sot ky Kuvend arriti deri diku të ushtrojë funksionin e vet, arriti t'i miratojë disa ligje, disa vendime, disa të tjera jo. Dhe, unë mendoj që pavarësisht saj, ne edhe aty ku s'arritëm të kemi votimin e disa pikave, iu rikthyem atyre, disa kaluan, disa s'kaluan.

Për sa i përket rezolutës në fjalë, shumica dërrmuese e deputetëve kanë pasur dakordim edhe gjatë seancës kur është diskutuar, për ata që kanë harruar, edhe për sa i përket tekstit të rezolutës. Por, nuk kam si të mos shpreh mospajtimin e plotë me logjikën e kushtëzimeve. Nuk ka mundësi të kushtëzohet njëri-tjetri, ta kemi të qartë. Ju që po doni kushtëzime, kolegë të nderuar, socialdemokratë, të dy grupeve socialdemokrate, zoti Sherifi edhe zoti Ymeri, nuk po doni të kalojë rezoluta. Nëse thoni ja kështu, ja ashtu, atëherë edhe unë po them, e jo valla, nuk po bëhet qysh po doni ju. Nuk ka logjikë të tillë, kur ju me zor doni të impononi një agjendë. Ne u dakorduar për agjendën, i votuam disa gjëra, i mbështetëm ato propozimet e opozitës, edhe opozita i mbështeti disa propozime të Qeverisë, të koalicionit, por ju kisha lutur, mos e bini punën me kërcënime të kësaj natyre të thuhet s'ka punë në Kuvend nëse s'kalon.

Pra, po e mbyllim seancën, kurrjë kurrkujt. Prapë shihemi muajin tjetër, nuk ka problem, po a e keni në mend, pasi po thoni mbylle seancën, a keni në mend të kryer punë, a keni ndërmend të dilni në konferenca për shtyp dhe në status në Facebook. Nëse keni në mend të kryeni punë, kjo s'është mënyra, nëse e keni për Facebook, në rregull është, s'po jua votojmë propozimin, s'marrim pjesë në votim, e kryejmë seancën dhe ju thoni në Facebook që, ata s'na votuan se ne deshëm ta rrisim rrogën. Sa është paga minimale, cili është niveli? Pse nëse keni dashur të rritet paga minimale, s'e keni përcaktuar shumë? Pse s'e keni përcaktuar shumë? Pse s'i keni rekomanduar Qeverisë të bëhet 300 euro paga minimale? Jo, t'i rekomandohet Këshillit Ekonomik Social, se rezoluta nuk është obligative, ne e dimë, se i kemi bërë edhe 50 rezoluta të tjera që nuk i ka respektuar një institucion i ekzekutivit.

Ama dëgjoni, nëse duam të kalojmë diçka, e kalojmë, por jo me këtë farë logjike se s'kalon. Shkurt, nuk kalon dhe nuk është e saktë që s'keni mundur të rekomandoni, ne s'e kishim përcaktuar pagën minimale, se atë e bën Qeveria me rekomandim të Këshillit Ekonomik Social, po kemi mundur t'u themi po propozojmë 300 euro të bëhet paga minimale, 250, pse s'keni guxuar? E po, tash nëse është propozimi i Këshillit, e kemi mbështetur të gjithë këtë farë rezolute, mos e bini punën këtu për shkak të qasjes kërcënuese, kushtëzuese dhe shantazhuese të mos e kalojmë këtë farë rezolute.

KRYETARI: Po, dy deputetë janë përmendur, zoti Sherifi edhe zoti Ymeri.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Së pari, kjo çështja e ngarendjes pas meritave, Memli, më shumë ju shkon juve për fytyrë, po s'po dua të hyj andej, se vërtet po dua të kryejmë punë. Nuk është duke u bërë kjo as për statuse, nuk është duke u bërë as për merita, thjesht kërkova konsistencë të votës me debatin.

Nëse në debat krejt bëjnë vrap për merita dhe për statuse në Facebook dhe për të dalë te kategoritë e prekura e të thuhet që 'pa neve kjo s'bëhet', unë nuk e bëra për atë. Memli, ti e di që ka gjëra që i kemi votuar për shkak të koalicionit dhe nuk të kam detyruar ty atje të thuash ma ndërrova fjalën, s'ta kam sjellë punën, se këtu i kam kryer, këtu jemi marrë vesh dhe unë kur e thashë atë, më së paku t'u drejtova ty apo juve, po meqë ti e nxore në atë plan, po të përgjigjem. Unë iu drejtova të gjithë deputetëve, të gjitha grupeve parlamentare që kanë marrë pjesë në debat, ku të gjithë njësoj kanë thënë se duhet të punohet në këtë drejtim. Nëse ju kujtohet, besoj se ty të kujtohet që nuk je prej atyre që ke memorien e dobët, veç pos nëse ke qenë duke pirë duhan, s'ke qenë në sallë, të gjithë kanë thënë që të mos e caktojme shumë, sepse e kushtëzojmë Qeverinë, ia diktojmë Këshillit Ekonomik-Social se sa duhet me qenë.

Pra, le t'ia lëmë Këshillit Ekonomik-Social që ta përcaktojë shumë, përmes rezolutës të shprehet vullneti që të punohet në këtë drejtim. Prandaj, rezoluta është, le të themi është zbut në këto përmasa jo se ne nuk kemi dashur, se ti e di që ka qarkulluar një shifër herë 250, herë 270, 280, po kanë thënë që le t'ua lëmë aktorëve të merren me këtë çështje.

Dhe, nëse ti do ta marrësh si kërcënim, si shantazh, merre, por nuk e pata për atë qëllim dhe, jo rrallë grupet parlamentare në krejt botën thonë që 'nëse kjo nuk më kalon', sidomos kur ato kanë të bëjnë me thelbin e programit të saj, me kauzën e saj, kanë të drejtë edhe politike, edhe morale që të thonë "sorry, më fal, nuk mund të vazhdojmë më tej derisa nuk e zgjidhim këtë çështje", kjo është normale në botën demokratike. Nëse ti si ballkanas i përbetuar e merr këtë edhe personale, atëherë është diçka tjetër, por nuk pati asgjë personale, madje as partiake. Thjesht, ne e kemi shumë të rëndësishme këtë si Nismë Socialdemokrate, e kemi edhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministër i cili në vazhdimësi ka bërë përpjekje ta kryejë këtë çështje

brenda Qeverisë, në pamundësi që kjo çështje të kryhet në Qeveri, ka ardhur në Parlament, ju e dini mirë.

Prandaj, unë po insistoј që të rihidhet edhe një herë në votim, në mënyrë që t'i jepet epilog kësaj, përndryshe shkojmë në pushim dhe kurdo që të merremi vesh, sepse në krejt botën ndodh kjo, partnerët e koalicionit kur nuk merren vesh për një çështje, tërhiqen edhe i fillojnë negociatat derisa të merren vesh. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Ymeri, pastaj ndërkohë ka kërkuar zoti Krasniqi kundër-replikë. Po, zoti Ymeri në emër të PSD-së.

VISAR YMERI: Faleminderit, edhe një herë, kryetar!

Nuk prita që do të bëhej një debat i tillë në këtë moment dhe po dua edhe një herë ta qartësoј se çka thashë. Pra, unë thashë që kjo çështje duhet të marrë epilog me votë të deputetëve sot. As nuk thashë që do të jetë epilog pozitiv, as negativ...

Natyrisht që unë i ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë pozitivisht këtë rezolutë sepse për mua kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme që të bëhet nga Kuvendi e që të vazhdoј si procedurë nëpër institucionet përkatëse, Këshilli Ekonomik-Social dhe pastaj Qeveria e Republikës së Kosovës, në mënyrë që sa më shpejt të merret vendimi për rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës. natyrisht që ka deputetë dhe mund të ketë deputetë të cilët janë kundër, mirëpo le ta deklarojnë votën e tyre kundër dhe të tregojnë pse janë kundër.

Çka nuk dua të ndodhë sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës për këtë çështje dhe çështje të tjera, e sidomos jo për këtë çështje, është që deputetët të fshihen prapa mosvotimit. Pra as të mos thonë po, as të mos thonë jo. Sepse kjo po nënkupton jo. Nëse e keni jo votën cilido prej grupeve parlamentare, ju i PDK-së, ose deputetë të caktuar të PDK-së, ju të tjerët që s'po votoni, votoni ju, edhe tregoni pse jeni kundër pagës minimale, edhe në rregull jemi.

Pra, nuk është ky kërcënim e as shantazh e as nuk është imponim i agjendës së caktuar. Kjo është kërkesë në fund të fundit që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli Ekonomiko-Social ta respektojnë Ligjin e punës dhe ligjet e tjera përkatëse që e rregullojnë fushën, e ku thuhet që është obligative që për çdo vit të diskutohet dhe të caktohet një nivel i pagës minimale dhe pastaj të miratohet nga Qeveria.

Një e tillë si propozim është bërë nga Këshilli Ekonomik-Social në vitin 2017, ku është propozuar që paga minimale të ngrihet nga niveli 170 euro dhe 130 përkatësisht, në nivelin 250 euro. Po kjo nuk është bërë vendim qeverie, dhe natyrisht që këtu duhet të ndërhyjë Kuvendi tash. Pra, kërkojmë edhe një herë Këshilli Ekonomik-Social me përbërjen e re të marrë vendim dhe t'i propozojë Qeverisë, në mënyrë që Qeveria pastaj ta zbatojë këtë vendim. Këtë e kërkon

rezoluta. Kuvendi nuk mund të caktojë shumë, sepse nuk është në përgjegjësinë tonë, po ne kemi folur secili prej nesh, e ka dhënë një ide dhe një mendim sesi do të duhej të zgjidhej kjo.

Po për mua është jashtëzakonisht e rëndësishme të etablohen tri gjëra këtu, para se të flasim për shumën. E para, për çdo vit duhet të diskutohet dhe të përcaktohet paga minimale. Nuk bën të lihet kështu me një kohë të gjatë, sepse pastaj po është edhe më problematike për ta trajtuar atë. E dyta, nuk ka kurrfarë kuptimi që të kemi paga të ndryshme minimale, sipas moshës, pavarësisht moshës së të punësuarit, paga minimale duhet të jetë në nivel vendi, e njëjtë për të gjithë.

Dhe e treta, domosdoshmërisht duhet që institucionet e Republikës së Kosovës, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Ligjin e punës që ta bëjnë llogariten sa më objektive e sa më transparente të vlerës së pagës minimale, në mënyrë që të gjithë pastaj ta kenë edhe të mundur ta kuptojnë, edhe të mundur të pozicionohen e të kenë mendim për një shumë të caktuar.

Prandaj edhe një herë, kërkoj që kjo rezolutë të vihet në diskutim. Unë siç e përmenda, ne kemi bërë ftesë si grup parlamentar, si iniciues të kësaj rezolute dhe të debatit, të gjitha grupeve parlamentare, që të ulemi bashkë dhe t'i harmonizojmë tekstet meqë ka pasur ide të ndryshme dhe kërkesa të ndryshme dhe kësaj ftese i janë përgjigjur grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe grupi i Nismës Socialdemokrate. Ju të tjerët nuk i jeni përgjigjur. Ju kam pyetur nga dy herë, a do ta dërgoni nga një përfaqësues, disa më keni thënë po e dërgojmë e s'e keni dërguar, disa të tjerë s'keni kthyer përgjigje fare. E kemi pasur një proces të diskutimit të kësaj rezolute dhe të harmonizimit me ata që kanë qenë të interesuar ta harmonizojnë. Të tjerët le të votojnë si t'ua merr mendja, por le të votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Krasniqi kundër-replikë. Po, po. Pastaj e kanë fjalën Armendi dhe zoti Isufi.

MEMLI KRASNIQI: Së paku m'i jepni dy minuta ndoshta, pasi të dy parafolësit iu adresuan asaj çka thashë.

Kolegë, tash ishit pak më ndryshe sesa kur folët herën e parë, sepse ishit shumë kushtëzues. Nuk ju kam keqkuptuar as njërin as tjetrin. Ishit, s'po them tjetër send, kushtëzues. Ja do të votohet kjo, ja po e ndalim seancën. Dhe unë absolutisht kam problem me një këso. Mund ta qesim në votim, a ju kalon a s'ju kalon, është çështje tjetër. Po të thuash, jo valla nëse s'kalon, asi. Për mua është shumë i rëndësishëm Ligji për tatim në korporata. Për një votë nuk kaloi një amendament. E çka, ta ndalim seancën a? S'kishte ardhur as deri te votimi, as të provohet të votohet këtë farë rezolute. Dy herë, tri herë e qitëm në votim dhe ka të bëjë me amendamentin 5 të atij ligji, i cili e mundëson sponzorizimin e sportistëve dhe e njerëzve të artit e të kulturës dhe

të rinisë dhe ky Kuvend prapë nuk e mundësoi një gjë të tillë, e unë e konsideroj një prej temave ndoshta më të rëndësishme, dhe tashti dua t'ju kushtëzoj a?

Nuk e mora aspak personale zoti Sherifi. Të paktën njihemi. Më së paku personale e marr çështjen e pagës minimale. Jo pse nuk e konsideroj si temë të rëndësishme, po s'kam arsye ta marr personale. Qëndrimi ynë për këtë punë dihet, është shprehur edhe në seancë kur është diskutuar kjo punë. Dhe po ashtu, nuk është zoti Visar Ymeri, ku është për të dhënë, le të tregon kushdo asi. Vota është e lirë, kushdo mund të votojë për çfarëdo arsye si të do. Nuk ka imponim në votë. Dhe arsyeja e votës së cilitdo qoftë, qoftë kundër, nuk është bre gjyq me e qit gjithqysh në gjykatë, t'i thuhet pse e ke votuar. A të pyeta unë ty për një votë tënden pse? A po pyes unë të spinoj të them pse ju s'votuat pro sportistëve të Kosovës, pse ju s'votuat pro artistëve të Kosovës. Jo, s'e votuat, në rregull. Jam i zhgënjyer, por ne vazhdojmë tutje. Edhe kjo, le të kryhet.

KRYETARI: Zoti Armend, e pashë kërkesën për fjalë. Edhe zoti Isufi, pastaj ishim futur në votime këto çka i kemi. T'i përfundojmë ju lutem.

ARMEND ZEMAJ: Unë e kërkoja pak më herët. Ndoshta shumë më herët para se të zhvillohet ky debat. Sepse tash duket që të mos shfrytëzohet kjo situatë për të dhënë fraza moralizuese për gjendjen dhe realitetin çfarë është në Kuvendin e Kosovës, me paraqitjet, sidomos të qëndrimeve këto çka po quhen kushtëzime, shantazhe, sidomos në një mazhorancë e cila duhet t'i ketë disa dakordime paraprake para një votimi, nëse këta po e konsiderojnë të rëndësishëm.

Sepse, për një deputet të Kuvendit të Kosovës, për një subjekt politik, nuk ka votim të rëndësishëm, edhe të parëndësishëm, as rezolutë të rëndësishme, as të parëndësishme, sepse atëherë devalvimi dhe zhvlerësimi i institucionit të Kuvendit po ndodh nga këto deklaramë, sidomos në respektimin e rezolutave që dalin nga vota e lirë e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. A nuk është e rëndësishme që të votohet kundër çdokujt që tenton të bisedojë për korrigjim apo për ndryshim të kufijve? Nuk është e rëndësishme që të votohet kundër veprimeve që nuk kanë sjellë liberalizimin e vizave? Keni Raportin e Progresi të ditës së djeshme.

Andaj këto interpretime çfarë i japin e tregojnë realitetin kushtëzues, fatkeqësisht klientelisë edhe të votës, edhe të qëndrimeve politike në Kuvendin e Kosovës. Po kjo ndodh Kryetar, aty po kthehem në fillim, ju po gaboni sepse po lejoni, apo po insistoni në ndërrimin e pikave për votim në renditjen çfarë janë të përcaktuara dhe shiheni gjendjen e cila është e pjesëmarrjes së deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Ju po i lëvizni pikat e rendit të ditës ashtu sikurse juve po ju konvenon, apo një grupi politik dhe tek atëherë vjen te rëndësia e këtij debati, apo mosrëndësia e këtij debati, se çka është e rëndësishme dhe çka është e parëndësishme. Çka vazhdon dhe çka nuk vazhdon. Andaj kërkoj... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë zoti Isufi të lutem. A u ndal, a? O Armend s'ta ndal kush fjalën sa të jem unë këtu. Lëshoja regjia hala, hala. Ende, ende. Regjia e ndali, kërkoj falje Armend.

ARMEND ZEMAJ: Nuk e di pse e ndali regjia. Sigurisht gabim teknik se ishte në kontekst të fjalës, jo të replikës, por kjo është ajo çka e mendova.

Ju lutem respektojeni rendin e ditës. Jo pikat e caktuara dhe pikat e rëndësishme dhe të parëndësishme. Për neve të gjitha janë të rëndësishme. Vendosim me votë sesi do t'i përcaktojmë. Por në momentin kur kthehen dhe bëhet ridebat edhe për pikën e caktuar, grupi parlamentar e ka dhënë kontributin dhe e ka përkrahur pikën, po jo në këtë formë çfarë po e përdor mazhoranca. Edhe atë ditë nuk kemi pasur harmonizim të qëndrimeve në mes të koalicionit qeverisës, ministrit të Financave, Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës dhe grupeve politike. Andaj mos na qitni në situata të tilla, ku tash kërkohet një rideklarim i ri, edhe duke krijuar gjendje të re për një pikë të caktuar, për të cilën ka qenë një dakordim paraprak edhe shumë i harmonizuar pa ndonjë dilemë se a duhet të harmonizohet një rezolutë e caktuar apo jo. Por, elementi kushtëzues është elementi më i keq që individë të caktuar dhe grupe të caktuara e kanë futur në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Isufi edhe do të shkojmë. Unë e kthej edhe një herë në votim. Këtë mund ta bëj, më shumë s'mund të bëj.

AHMET ISUFI: Faleminderit Kryetar! As s'pati nevojë për këtë debat fare. Grupet parlamentare janë pajtuar, Qeveria është pajtuar që të përcaktohet paga minimale. Është lënë që Këshilli Ekonomik-Social ta përcaktojë, madje është përmendur edhe koeficienti i parë. Pse ka nevojë tash përsëri ta kthejmë në debat. Qite në votim, e votojmë, edhe kalojmë në pikat e tjera.

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë edhe një herë në votim. Kërkoj falje, veç a kthej.

Sa deputetë i kemi në sallë, regjia? Po, të lutem!

Do të thotë kemi të bëjmë me pagën minimale, e cila ka dalë si rezolutë nga interpelanca me Kryeministrin e Republikës së Kosovës lidhur me mosçaktimin dhe rritjen e pagës minimale.

Shkojmë në votim të Preojkt-rezolutës. 66 deputetë janë mjaft në sallë. Votojmë tash!

Kuvendi miratoi rezolutën e propozuar nga GP i PSD-së.

6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,

- Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës,

- Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radhët e komuniteteve joshumicë,

- Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1)anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë.

A e pata vëmendjen e juaj? Janë të gjitha këto komisione që krijohen. Në qoftë pajtoheni, formohet një komision, ose shkoni secilën ndaras një për një. Kjo është vendimmarrja juaj. Jo i ndaj unë, s'është problem, mos u shqetësoni. Jo, si të doni. Në qoftë se doni t'i ndani, vetëm vëmendje! Nuk di a e keni në dokumente. E keni komisionin ad hoc, kur i jepni emrat. Mos t'ia jap pesë herë të njëjtit fjalën përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

I keni dërguar emrat? Janë disa. Atëherë kështu, për Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës na jep emrat. Të shkojmë një për një, ju lutem!

ARMEND ZEMAJ: Po Kryetar i kemi emrat, sepse paska një ndryshim nga seanca e kaluar.

KRYETARI: Dy duhet.

ARMEND ZEMAJ: Po, fakt, se dy komisione qenkan për bord të RTK-së.

KRYETARI: Jo vetëm këtë.

ARMEND ZEMAJ: Urdhëro!

KRYETARI: Vetëm këtë. Jemi te zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Po e ndarë në dy komisione. Nëse unë e kam me të renë. Me të vjetrën është një.

Atëherë për pjesën e parë, sa i përket komisioneve ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për borde të RTK-së, Armend Zemaj dhe Doruntinë Maloku.

Ndërsa për përzgjedhjen e kandidatëve të Këshillit të Pavarur të Shërbimit Civil të Kosovës, Arban Abrashi dhe Mirjeta Kalludra.

Dhe për formimin e komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, Arban Abrashi, Imet Rrahmani.

KRYETARI: Ok, i mban mend, në qoftë se kanë nevojë deputetët, jua thua prapë. Jo, jo, e the shumë mirë. Janë në procesverbal, mos u shqetëso. Janë në procesverbal për fat të mirë. Po veç te mbamendja këtu në seancë, në qoftë se ka dikush dilema.

Partia Demokratike e Kosovës ka propozuar Xhevahire Izmakun e Nait Hasanin.

Lëvizja Vetëvendosje Valon Ramadanin, Sami Kurteshin.

AAK, të lutem një anëtar!

AHMET ISUFI: Rasim Selmanaj.

KRYETARI: Rasim Selmanaj. PSD-ja, një anëtar. Regjia te Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Fisnik Ismajli.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe nuk është prezentë. Zëvendëskryetarin e dytë. Nisma, të lutem Bilall.

BILALL SHERIFI: Haxhiu flet.

KRYETARI: Haxhi, të lutem! Milaim Zeka. Atëherë edhe 6+, ju lutem!

ALBERT KINOLLI: Zotëri Kryetar faleminderit. Ne ende s'jemi dakorduar plotësisht. Ndërkohë i dërgojmë emrat.

KRYETARI: E atëherë se duhet t'i votojmë në seancë. Unë së shpejti do ta thërras seancën me këto pika të vazhdimit, pasi edhe komisioni është... Urdhëro, në qoftë se jepni emrin ose duhet me... Urdhëro, zotëri Albert.

ALBERT KINOLLI: Në formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, shkoj unë, Albert Kinolli.

KRYETARI: Faleminderit! Procedojmë me votim në mënyrë formale. A janë 61 deputetë? A është dikush kundër? Së pari a janë 61 deputetë në sallë? Votojmë për prezencë në mënyrë elektronike. Ju lutem, votojmë vetëm prezencë. Votoni tash!

Kemi deputetë të mjaftueshëm. Shkojmë në votim në mënyrë formale. A është dikush kundër? Fjala është për emrat të cilët u propozuan. Abstenim a ka? Kalojnë të gjithë.

Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që të veprojnë në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr. 04/L-046 për RTK-në, dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Xhevahire Izmaku, kryetare, zëvendëskryetari i parë Valon Ramadani, ndërkaq i dyti do duhej të ishte nga Lista Serbe.

- Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Grupi Parlamentar i LDK-së propozon zëvendëskryetarin e parë dhe një anëtar. Zotëri Zemaj e keni fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Doruntinë Maloku, zëvendëskryetare, Armend Zemaj, anëtar.

KRYETARI: Faleminderit! PDK-ja dy anëtarë. Memli, dy anëtarë.

MEMLI KRASNIQI: Ne e propozojmë deputeten Blerta Deliu-Kodra dhe deputeten Safete Hadërgjonaj.

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, dy anëtarë.

GLAUK KONJUFCA: Valon Ramadanin dhe Shemsi Syla.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetarin e komisionit.

AHMET ISUFI: Ne e propozojmë Rasim Selmanajn.

KRYETARI: Faleminderit! PSD-ja një anëtar. Zonja Shqipe, ju lutem!

SHQIPE PANTINA: Unë, Shqipe Pantina.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe nuk është këtu. Nisma, propozojeni një anëtar ju lutem.

HAXHI SHALA: Veton Berisha.

KRYETARI: 6+ le ta propozojë zëvendëskryetarin e dytë.

ALBERT KINOLLI: 6+ propozon Danush Ademin.

KRYETARI: Faleminderit! A është dikush kundër? Abstenim a ka? Aprovohet. 64 deputetë janë në sallë, 74 në fakt, shumë mirë.

Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Ngarkohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës që të veprojnë në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

- Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radhët e komuniteteve joshumicë
Grupi Parlamentar i LDK-së duhet t'i propozojë dy anëtarë të komisionit.

ARMEND ZEMAJ: A na takon kryetari këtu? Fidan Rekaliu dhe Mirjeta Kalludra.

KRYETARI: PDK-ja zëvendëskryetarin e parë dhe anëtarin. Memli, urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Më fal kryetar! Zoti kryetar, a ka mundësi që ta specifikosh se a i kemi dy anëtarë për KPM-në, minoritet. Dy anëtarë a po?

KRYETARI: Po, dy. Zëvendëskryetarin e parë edhe anëtarin.

MEMLI KRASNIQI: Zëvendëskryetar në këtë proces, në këtë komision, ne e çojmë Andin Hotin dhe anëtar e çojmë Evgjeni Thaçi-Dragushën.

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje ju lutem.

GLAUK KONJUFCA: Ne e propozojmë Valon Ramadanin dhe Ali Lajçin.

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës?

AHMET ISUFI: Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! PSD-ja, po ashtu një anëtar.

SHQIPE PANTINA: Kryetar, vetëm një sqarim, se diçka tjetër propozuat ju...

KRYETARI: Lëvizja Vetëvendosje, a e dhatë emrin për kryetarin? Se njëri ishte kryetar. Glauk Konjufca, regjia.

GLAUK KONJUFCA: Valon Ramadanin e propozojmë për kryetar.

KRYETARI: Faleminderit! PSD-ja, ju lutem zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Fillimisht të sqarojmë diçka. Kur ju kërkuat propozimet thatë, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Kur Memli propozoi emrat tha, Këshillin e Pavarur të Mediave.

Kështu që propozimet tona janë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil... I ke dy, na i sqaro edhe një herë.

KRYETARI: Vetëm, kisha pasur dëshirë për vëmendje për atë që e lexoj unë. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

SHQIPE PANTINA: Në rregull. Atëherë, Dardan Sejdiu.

KRYETARI: Faleminderit! Lista Serbe nuk është këtu. Nisma, ju lutem Haxhi.

HAXHI SHALA: E propozojmë Enver Hotin.

KRYETARI: Faleminderit! 6+ kë e propozon, Albert?

ALBERT KINOLLI: Grupi Parlamentar 6+ propozon deputetin Bahrin Shabani.

KRYETARI: Faleminderit! A është dikush kudër? A dëshiron ta ndërrosh propozimin. Atëherë, ndërroje sa më parë, sa nuk e kemi votuar se pastaj...

MEMLI KRASNIQI: Atëherë, ne i kemi aty nënkryetarin dhe një anëtar a po? Unë e propozoj në pozicionin e nënkryetares Luljeta Veselaj-Gutajn dhe anëtar Mërgim Lushtakun.

KRYETARI: Faleminderit! Është e drejtë e Grupit Parlamentar. A është dikush kundër për sa i përket kësaj përbërjeje? Nuk ka. Abstenim, a ka? Nuk ka. Votohen të gjithë.

Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Shkojmë më tutje, si ngarkohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e këtyre dy anëtarëve dhe të veprorë në përputhje me nenin 10, pikat 4,5 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

- Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1)anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë

LDK-ja t'i propozojë kryetarin dhe anëtarin.

ARMEND ZEMAJ: E propozojmë Arban Abrashin për kryetar, ndërsa anëtar Imet Rrahmanin.

KRYETARI: Faleminderit! PDK-ja, dy anëtarë.

MEMLI KRASNIQI: Ne i propozojmë Andin Hotin dhe Evgjeni Thaçi-Dragusha.

KRYETARI: Lëvizja Vetëvendosje i propozon dy anëtarë.

GLAUK KONJUFCA: Valon Ramadani dhe Arbër Rexhaj.

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e propozon një anëtar. Zotëri Isufi, e keni fjalën. E di se jeni lodhur edhe s'keni faj.

AHMET ISUFI: E propozojmë Rasim Selmanajn.

KRYETARI: PSD-ja?

SHQIPE PANTINA: Dukagjin Gorani.

KRYETARI: Lista serbe nuk është këtu. Nisma kë e propozon?

HAXHI SHALA: E propozojmë Etem Arifin, i nderuar.

KRYETARI: Në rregull! 6+, ju lutem!

ALBERT KINOLLI: Grupi Parlamentar 6+ propozon deputetin Fikrim Damka.

KRYETARI: A është dikush kundër për këta emra? Abstenim a ka?

Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatit për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komuniteteve tjera jo shumicë. Edhe ky Komision ad hoc ngarkohet nga Kuvendi që të vazhdojë procedurat në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të cilat i ka Kuvendi.

A të shkojmë në pauzë?

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara

A e votojmë tash këtë propozim? Po e shoh, ka insistim.. A dëshironi të shkojmë në pauzë, apo dëshironi ta thërrasim vazhdimin e seancës për një ditë tjetër, në mënyrë që edhe ky komisioni në fillim e kryen punën e vet.

Brenda momentit unë konsultohem me grupet parlamentare dhe e ftoj një ditë tjetër. A shkojmë një ditë tjetër? Po e shoh që të gjithë... Atëherë, do t'ju ftoj një ditë tjetër për vazhdimin me pikat e papërfunduara.

Faleminderit! Urime dhe suksese!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*